



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Më: 28 prill 2026

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 28 prill 2026 (e martë) në sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:00.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Simir Krasniqi, Kryesues i KPF-së, Ymran Fusha, Trëndelina Kastrati, Dafina Alishani, Ilir Gashi, Haziz Hodaj, Agnesa Sinanaj Gavazaj dhe Shukri Quni, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mungoi: Arianit Berisha

Pjesëmarrës tjerë ishin: Islam Ukimeri – Drejtor i Shërbimeve Publike, Elsabah Xhurxhehalo – Drejtor i Pronave, Levent Bus – Drejtor i Ekonomisë dhe Financave, Ymer Berisha – Zyrtar nga zyra për komunikim dhe informim, Lulzim Sylejmani – Zyrtar nga drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Përparim Shala – Zyrtar nga drejtoria e Shërbimeve Publike, Gursel Skënderi – Zyrtar nga drejtoria e Pronave, Dafina Krasniqi – Asistente e Kryesuesit të Kuvendit, dhe përfaqësues nga shoqëria civile dhe mediat lokale.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë po fillojmë pra. Të nderuar anëtarë të Komitetit për politikë dhe financa, të nderuar përfaqësues të mediave, drejtorë të ekzekutivit, zyrtarë komunal, të nderuar të pranishëm, sot po e mbajmë mbledhjen e katërt për vitin 2026 të Komitetit për politikë dhe financa. Të pranishëm jemi tetë (8) anëtarë të KPF-së, pra Komitetit për politikë dhe financa, meqënëse kemi kuorum të mjaftueshëm, po e fillojmë me këtë mbledhje. Materialin dhe ftesën për mbledhje ju kemi shpërndarë me kohë, sipas afateve ligjore. Për punën e kësaj mbledhje të Komitetit për politikë dhe financa, KPF-së, do të jetë ky rend dite. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të KPF-së të datës 27 mars 2026. A kemi me shtu diçka rreth procesverbalit. Atëherë që nuk kemi me e shtu, e hedhim në votim procesverbalin pra të datës 27 mars 2026, sa jemi për? Unanimisht pra me tetë (8) vota votohet pra procesverbali apo miratohet procesverbali i datës 27 mars. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës, pika e dytë. Pika e tretë, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashfrytëzuara nga të hyrat vetanake për vitin të vitit 2025 në vitin 2026. Pika e katërt shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për subvencionimin e transportit urban. Pika e pestë e rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i propozimit vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001-011-25151 të datës 26/2/2026 për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të

palujtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2026 sipas kërkesës së MAPL-së. Pika e gjashtë, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës të drejtorisë komunale të arsimit. Pika e shtatë: shqyrtimi dhe miratimi i projekt planit të veprimit për transparencë 2026-2030 sipas kërkesës së MAPL-së. Dhe pika e tetë raporti financiar për periudhën janar-mars 2026. Ky pra është rendi i ditës. Keni me shtu para se ta hedhim në votim? Po drejtor.

Islam Ukimeri: Se reagoja pak më herët. Faleminderit shumë, faleminderit për të gjithë të pranishmit këtu. Unë kam me shtu në aspektin e kur e kemi bërë votimin e dy aksionarë të ndërmarrjeve publike ndërmarrja e stacionit të autobuseve dhe ekoregjionit. Na u ka kthyer prap nga ministria e financave, për shkak të pagesës dhe thash do ta shtymë edhe njëherë këtë seancë t'i votojmë t'i zgjedhim aksionerët e dy ndërmarrjeve dhe kemi heq atë pikën e pagesës, për shkak ka mundësi ndoshta që kryesuesi e shpjegon pak më mirë çështje që ky është marrë me këto kërkesa. Po ne duhet t'i shtimë edhe njëherë t'i bëjmë përzgjedhje dhe të votojmë edhe njëherë kandidatë për që janë për aksionerë të dy ndërmarrjeve.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kështu drejtor, neve na është kthyer shqyrtimi pra miratimi apo nga ministria e ekonomisë dhe financave. Ku te neni i katërt thotë që të largohen, ku kemi thënë që aksionerët të kompenzohen prej ndërmarrjet publike, ne kemi lyp sqarim edhe kemi marrë dy komuna si model që komuna e Fushë Kosovës i njëjti vendim është kaluar pra nga MAPL-ja edhe komuna e Therandës. Dhe na kanë kthyer prapë që ky nen duhet të largohet më vonë me një vendim të veçantë pra të votohet në kuvend për kompesimin e aksionerëve. Dhe në këtë rast pra ne duhet të veprojmë në bazë të kërkesës së ministrisë së ekonomisë dhe financave, neni i katërt është larguar pra nga vendimi. Vendimi mbetet i njëjtë, aksionerët nuk votohen vetëm ndryshimi pra i neni katër apo plotësim ndryshimi. Që keni me shkruar diçka këtu, që nuk keni atëherë.

Haziz Hodaj (LDK): Kjo nuk është në rend të ditës apo?

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo që duhet ta fusim se unë i kam bërë që i kam edhe kërkesa në qoftë se doni, që e kemi marrë përgjigjen prej ministrisë së ekonomisë se si na janë përgjigj ata. Ne duhet ta fusim pra në rend të ditës pa nenin katër.

Islam Ukimeri: Realisht nëse më lejohet. Prishtina, Fushë Kosova dhe Suhareka faktikisht Prishtina e ka bërë me një vendim, kryetari ja ka bërë, kryetari i komunës ja ka bërë vendimin për pagesë, që ka obliguar ndërmarrje që me bërë pagesën për shkak që kryen shërbime te ndërmarrja, ndërsa Fushë Kosova dhe Suhareka ja ka pranuar, këto që kena votuar ne herën e fundit, të njëjtin vendim e ka pranuar për Fushë Kosovën dhe Suharekën. Ndërsa ne si komunë na ka tërhekur që nuk bën bëhet pagesa prej ndërmarrjes. Pak e di pak shumë e përzgjidh kjo çështje po ndoshta u kon mirë me heq krejt këto si pagesë me u votu si aksionar vetëm ajo pika që është katër largohet mir e tha kryesuesi kërkoj falje. Por mandej për një vendim qoftë të asambles apo të kryetarit që ata që kryejnë shërbimin brenda ndërmarrjes duhet të paguhet pra është shumë logjikë. Nuk e di pse ai po kryen punë brenda ndërmarrjes, ndoshta ka një farë mundësie ta shohim bordi unë marrin vendimin për me u bë pagesa është rroga minimale që rroga më e vogël e ndërmarrje me pagu aksionar, nuk e di pse po kjo ta votojmë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Drejtor kjo mbetet më vonë pasi Prishtina i ka 10 ndërmarrje publike. Tash si vendoset për Prishtinën, se Prishtina është që ka ndërmarrje më së shumti. Ne në të

ardhmen do të vazhdojmë si të na udhëzojnë pra ministria e ekonomisë dhe financave për veprime të mëtutjeshme.

Islam Ukimeri: Unë e kisha për qëllim veç t'i informoj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, atëherë.

Dafina Alishani (LVV): A bën një pyetje lidhur me këtë pikën të cilën po e rekomandoni? Ju zakonisht kur keni çështje të cilat vijnë nga ministria mundoheni me pas edhe komunikime qoftë me telefon apo qoftë me zyrtarë që i keni atje. A keni mundur me ja shpjegu që komuna të tjera e kanë bërë këtë çështje dhe ndoshta me ja bashkangjit ato vendime? Edhe çka ka qenë arsytimi ose përgjigjja e tyre po më intereson se është shumë e palogjikshme.

Simir Krasniqi (Kryesues): Do të merremi me ato komuna. Ka mundur me qenë një lëshim i atyre komunave. Mundesh me hy në faqe të komunës së Fushë Kosovës, me pa vendimin.

Dafina Alishani (LVV): Fushë Kosovën vetë e kam rekomanduar si shembull.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë, rishqyrtimi i dy vendimeve sipas kërkesës së ekonomisë, pika e nëntë dhe pika 10. Pra pika e nëntë e rendit të ditës, vendim për formimin e komisionit komunal të aksionerëve të ndërmarrjes publike lokale, stacioni i autobuseve, shoqëria aksionare Prizren dhe si pikë e 10 e rendit të ditës vendim për formimin e komisionit komunal të aksionerëve të ndërmarrjes publike lokale ekoregjioni, shoqëria aksionare Prizren. E hedhim në votim që edhe këto dy pika pra t'i shohen rendit të ditës dhe t'i rekomandohen Kuvendit për mbledhjen e radhës pra që do të mbahet më 30 prill pra ditën e enjte.

Dafina Alishani (LVV): A ban edhe një pyetje?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po.

Dafina Alishani (LVV): Meqë kjo ka paska ardhur për herë të dytë. Kjo poget është edhe një shenjë për juve me i'a dhënë opozitës një aksionar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo nuk ka lidhje.

Shukri Quni (BDP): Kryesues?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po.

Shukri Quni (BDP): Përkundazi deshta me thënë se goxha keni shku rrotull për këtë komision. Që nuk hyni asnjë i opozitës, tu i marrë vetëm ju pozitë.

Islam Ukimeri: Jo në qoftë se atëherë ne kemi respekt edhe raporte të mira me ty, po ti sje në koalicion me neve.

Shukri Quni (BDP): Mundesh me pas raporte të mira shumë por në koalicion nuk jemi. Kështu që t'i kthen ministria kryesues sepse jeni duke bërë goxha do punë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Na kanë obliguar vetëm nënin katër la Shukë, nuk kanë cek aty.

Shukri Quni (BDP): Po apat kan me ta kthy.

Islam Ukimeri: Po pajtohem me Dabinën dhe me Ian Shuk se kur e kena pas Ademin në mandatin e kaluar aksionar na ka vërtetu të njëjtin mendim e kena pas njejtë po u pagu prej ndërmarrjes po ka qenë Ademi i Vetëvendosjes.

Dafina Alishani (LVV): Për hir të transparencës unë mendoj që edhe juve një hajer i ban me pas një anëtar të opozitës, për neve është shumë më problem. Po jo sun foli, sinqerisht kur e ke dikë prej opozitës ndryshe është edhe një monitorim pak më i denjë. Tash ju nëse doni me vazhdu ashtu, kjo nuk është mirë për demokracinë. Ju vetë e keni cekur që kur ka pas anëtarë të opozitës nuk ka pas ndonjë problem.

Islam Ukimeri: Ne s'mundemi me thënë kemi kaluar mirë.

Dafina Alishani (LVV): E tash kjo është një farë forme, vetbesimi i tepërt për numra në rregull vazhdoni ju, po a po e shihni që po vjen dita me kërkun edhe prej opozitës diçka.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë e hedhim në votim që këto dy pika t'i rekomandohen kuvendit pra si pikë e nëntë e rendit të ditës dhe pikë e 10 e rendit të ditës. Sa jemi për që t'ia rekomandojmë këto dy pika për propozimin e drejtorit. Me pesë vota për. Kundër? Tre kundër abstenim nuk ka. Pra këto pika i rekomandohen. Këto pika i rekomandohen kuvendit që të jenë si pika të rendit të ditës. Pika e nëntë edhe 10, pra, ku pika e nëntë është vendim për formimin e komisionit komunal të aksionerëve të ndërmarrjes publike lokale, stacioni i autobuseve, shoqëria aksionare Prizren dhe pika e dhjetë vendim për formimin e komisionit komunal të aksionerëve të ndërmarrjes publike lokale ekoregjioni shoqëria aksionare, Prizren. Vazhdojmë pra me pikat e radhës. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 për vitin 2026. Kemi drejtorin këtu apo zyrtari financiar që ta bëjnë prezantimin.

Lulzim Sylejmani: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Sipas afateve ligjore, domethënë ne kemi bërë një propozim vendim për pikë të rendit të ditës në këtë seancë për bartjen e të hyrave të tejkaluar dhe të pa shpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026. Domethënë është një procedurë që bëhet për çdo vit dhe kjo kalon në KPF, kalon në kuvend dhe i dërgohet ministrisë për alokimin e fondit të të pashpenzuar nga të hyrat vetanake. Kërkesa ka shumë nëpër ka pasur shumë nëpër drejtori siç e dini po këto janë qenë mjetet të cilat i kemi pas në dispozicion dhe nga këto mjete kemi menduar që të bëjmë më të mirën e mundshme aq sa ka pas mundësi nëpër pozicione të caktuara. Në arsim domethënë shkojnë 70.000€ te pagat në sektorin në arsimin fillor dhe këto janë mjetet të cilat do të paguhen për obligime të cilat janë krijuar në kategorinë e pagave te sektori i arsimit. Në sektorin e arsimit të mesëm janë 30.000€ po njashtu janë për pagat dhe për mësimin për të rritur që zhvillohet aty, në të njëjtën kohë ju njoftoj se te mësimi për të rritur aty edhe krijohen të hyra, faktikisht këto janë të hyra që janë krijuar në atë nivel nga participimi i atyre po mendoj që e ndjekin atë mësim domethënë mësim për të rritur. Mallrat dhe shërbime janë shkuar 100.000 euro në arsim për shkak se vitin e kaluar domethënë janë marrë diku rreth 400.000 euro në mallra dhe kanë mbet fatura të papaguara për pelet domethënë në periudhën e fundit të vitit dhe ai pelet që është bërë në furnizim vitin e kaluar domethënë është paguar me buxhetin e këtij viti dhe ne duhet të sigurohem që sado pak edhe pse obligimi është goxha i madh aty kemi mendu që me këto 100.000 ta zbusim atë obligim që e kena dhe të kena një furnizim për vitin, për fundvitin që që vjen. Te shërbimet komunale, po njashtu, domethënë vitin e kaluar domethënë në drejtorinë e arsimit janë marrë te komunalitë diku 140 e diçka mijë euro dhe në fund të vitit jemi rrezikuar që mos të kemi pagesa të faturave të rrymës dhe të kemi ndalesë të rrymës nëpër shkolla. Kryetari

është detyruar të çojë komunikojë të çojë një shkresë në keds dhe të kemi një si me thënë një shtyrje të afatit për mos shkyçe të shkollave dhe në fillim të vitit me buxhetin e këtij viti e kemi paguar obligimin e vitit të kaluar po është krijuar një obligim tjetër këta muajve që duhet me me mbyll. Te buxheti te drejtoria e financave janë shku te mallt e shërbimeve 121 mijë euro. Këtu është një kontratë e lidhur për tatimin në pronë që një kompani që e ka bërë evidentimin dhe regjistrimin e objekteve të reja që kanë qenë të paregjistruara me vite edhe normal që me atë regjistrim janë krijuar dhe të hyra në komunë, domethënë tash e shohim raportin e këtij muaji të hyrave dhe tash reflekton regjistrimi i atyre objekteve në të hyrat masi është shuar faktura në mars dhe aty janë planifikuar që me këto mjete të bëjmë shtyrjen e atij asaj asaj kontratës. Te kapitalet domethënë janë këto projekte të cilat i kemi listuar dhe të gjitha këto projekte që ne i kemi listuar këtu janë kanë të buxhetuar në këtë vit, operatorët kanë punuar dhe mjetet janë ekzekutuar në procedurë formarimore dhe kjo që po e shihni kjo shpërndarja që është bërë në këto projekte domethënë janë të gjitha obligime për punë që janë kryer dhe janë duke u kryer. Domethënë operatorët ekonomik, ju siç e dini kur e kemi aprovuar buxhetin, shumë pak ka pas projekte të reja, të gjitha janë shkuar për kontratat e lidhura ekzistuese, po edhe ato kontrata domethënë veç te shërbimet publike, domethënë 11 milion janë marrë në mars nga kapitalet, domethënë 11 milion edhe kjo shumë është simbolike për me i plotësuar ato dy tre kontrata, po thjesht domethënë jemi detyruar që të shkojmë në këto pozicione të cilat i kemi i kemi elaboruar dhe arsyet të cilat janë të shumica prej këtyre janë shku te shërbimet publike dhe një projekt që e kemi pas për bashkëfinancim me donatorë që ka qenë në pozicion në kuadër të drejtorisë së financave domethënë edhe aty 245.000€ i kanë marrë prej 250 ve që nuk kanë planifikuar. Te qekey projekti i në drejtori të financave për bashkëfinancim jemi duke e paguar atë 10% e energjisë që janë nëpër shkolla, nëpër objekte që me ministrinë me MAPL-në dhe kjo është ajo pjesa që prej këtij kodit e kemi paguar pjesën participuese që na takon baz marrëveshjes, kjo është pika të shkurtra ajo që e shpjegova, nëse kemi pyetje jemi këtu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Lulzim, e hapim debatin, atëherë që nuk kemi.

Dafina Alishani (LVV): Jo jo, kemi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, urdhëro.

Dafina Alishani (LVV): Një pyetje e kam, në seancën e kalume, u votu, u heçen këto pagesa për leje ndërtimore dhe u arsyetu që nëse me këste që ka qenë, po më intereson a keni mund me i akumuluar edhe ato pagesa ndoshta me i shtu këtu gjatë bartjes a janë të përfshira edhe ato prej periudhës domethënë prej seancës së kaluar a ka pasur ndonjë pagesë për ndonjë leje ndërtimore e cila kish mund me ju bashkangjitur kësaj shume se besoj që ndoshta një leje me pas lëshuar gjatë qasaj periudhe kish lujt rol goxha në shtimin e buxhetit këtu në bartje a është marrë parasysh edhe kjo apo jo? Edhe te çështja e domethënë kështu qysh i keni kategorizuar shërbimet publike dhe projektet, a janë shumat të cilat i kanë shumë borxhe operatorët ekonomik apo pse? Me dijeninë time ka edhe shumë linja të tjera buxhetore të cilat kanë borxhe ose ka fatura shumë të cilat komuna nuk i ka pagu sipas çkafit janë zgjedh këto linja buxhetore, te peleti e kuptova te domethënë që janë disa sende që janë më sensitive ato prioritizohen, po tek çështjet e investimeve kapitale sipas shkafit janë zgjedhur këto linja buxhetore.

Lulzim Sylejmani: Unë ju thashë që te drejtoria e shërbimeve publike janë ekzekutu mbi 11 milion euro, domethënë shërbimet publike kanë pas, nëse s'jam gabim, tash 16 milion krejt dhe 11 milion 14 dhe 11 milion janë marrë edhe shërbimet publike domethënë kanë vendosur që këto linja

t'i dërgojnë nëpër këto pozicione për shkak se këta operatorë, në bazë të vlerës së kontratës kanë qenë obligimet më të mëdhaja brenda drejtorisë së shërbimeve publike, domethënë askush tjetër ka vendosur kur me orijentuar përveç menaxherëve të kontratës që janë në kuadër të drejtorisë së shërbimeve publike. Sa i përket projektit që është te financat për bashkëfinancim ju tregova që aty është një marrëveshje për efikasitet të energjisë dhe pjesën participuese prej 10% e kësaj paguar vitin e kaluar me këtë pozicionit dhe kemi llogarit se tash janë 30 shkolla sa domethënë 78 objekte kanë me filluar me u bë rinovimi për çështjen e efikasitetit dhe pjesa jonë edhe pse është e pamjaftueshme kjo vlerë domethënë pjesa jonë si komunë domethënë ka pasur me ju paguar për atë për atë projekt. Sa i përket projektet shërbime publike ne kemi edhe drejtorin këtu mundet me dhënë arsyeshmëri. Dhe të mbeta borxh te pyetja e parë që tha këto janë të hyrat e bartura te me 31/12 të vitit të kaluar domethënë nuk janë leje të këtij viti lejet e këtij viti domethënë hyjnë për çdo muaj domethënë qysh ingasohen edhe po mendoj alokohen dhe shpenzohen. Këto janë të hyrat zakonisht të pashpenzume të vitit 2025 që kanë ndodhë temë 31/12 zakonisht kjo jetë muaji i 12, dyrat e muajit 12 ne nuk mund me i alokuar me i shpenzuar, zakonisht janë të hyrat e muajit 12, po ka edhe një të hyrë që ka mbetë ndër muajt pa pa u shpenzuar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Lulzim. Fjala për ju drejtor.

Islam Ukimeri: Më fal. Elaboroi edhe Luli komplet e tha qëndrojnë ato që tha. 11 milion mara tona është e vartit jo vetëm dy kompanive po i kemi 10 kompanive obligime vetëm një që bëni pyetjen. Ne kemi dhe kompani të tjera që kësaj ba shumë kompanive të tjera se i ka të gjitha po këtyre dy kompanive që janë që janë nda vetëm dy kompanive që janë 1 milion 1 milion 100 mijë duket 1 mil 1.1 po arsyen pse ne me me u nda nga 100 mijë euro nuk kësaj bërë zgjidhje, tani çfarë kësaj bërë për shkak që dy kompani u kanë marrë zero, domethënë këtyre dy kompanive kanë marrë komplet planifikuar për këtë vit këtë buxhet me ju kry obligimet me ju shty pak më tepër nga ndatet se këto janë obligimet e 2025s nuk janë obligimet e sivijet e me buxhetin e 2025 kësaj pas obligime këtë vit si lëshohet buxheti. Po ata s'na kanë lënë me lëshu hiç i kanë marrë menjëherë zero edhe tash ne për shkak mundësisë për me mund me punu diçka gjatë verës i kemi dhënë këto dy kompani kësaj i kësaj dhënë nga 500.000€ 450 tri 450 450 plus 50 plus 500.000 domethënë nuk kësaj mundur me ju bërë zgjidhje kompanive të tjera me nga 50 mijë 100 mijë s'kësaj mund me i bërë me se janë obligime pak më të mëdhaja. E kështu që për shkak që me i shlyer dhe me pas hapësirë me punu sido pas shadervan e ndo pjesë të tjera e kësaj bë se janë të rrugë të hapura që duhet me i përfundu për atë arsye dhe bëjn edhe përzgjedhje ne kësaj nevojë edhe për shumë kompani të tjera për pare s'kësaj.

Dafina Alishani (LVV): Më fal bre po në ortakoll ku është? Po ju po thoni që ne kësaj punu. Po në ortakoll përveç parkut ku keni bë rrugë dika tjetër. Ju po thoni që kësaj punu. Ku është punu drejtor?

Islam Ukimeri: Është punu nga dka-ja asfalti është bë?

Dafina Alishani (LVV): Po, tjetër? Çka u bë ajo?

Islam Ukimeri: E ke mbrapa te rruga ulqin jo, kjo pjesa mbrapa rrethi ish pumpës kabashi që ka qenë mbrapa.

Dafina Alishani (LVV): A janë projekte të përfunduara.

Islam Ukimeri: Puna është kry, projekti vazhdon hala. Projekti s'është mbyll, ka hala, ka afat hala, po pagesa s'kemi bë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për sqarime, a ka dikush tjetër? Që nuk ka, atëherë e hedhim në votim pikën e rendit të ditës që t'ia rekomandojmë kuvendit për mbledhjen e radhës, sa jemi për? 7 për kundër, nuk ka? abstenim 1, atëherë, pika e tretë e rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartjen e mjeteve të tejkaluara dhe të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026 i rekomandohet kuvendit në mbledhjen e radhës pra më 30/4/2026 ditën e enjte. Kalojmë te pika e katërt e rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për subvencionimin e transportit urban, e kemi këtu inicuesin e pikës, drejtori apo zyrtari i drejtorisë së shërbimeve publike do të na sqarojë.

Islam Ukimeri: Faleminderit kryesues. Unë do ta shpjegoj pak dhe ta elaboroj në mënyrën pak për çështjet teknike është edhe zyrëtari do ta spjegon. Kjo është një lajm shumë i mirë realisht për komunën e Prizrenit, për qytetarët e komunës se po bëhet hera e parë që po bëhet subvencionimi i udhëtarëve në komunën tonë, domethënë kjo është subvencionimi vetëm brenda zonës, brenda vetëm urbane qka është në qytet. Në këtë subvencionim që do të subvencionohet direktë operatorë që në momentin që shpallet liniat edhe fitojmë ky bëhet të gjithë kategorive domethënë prej pensionistëve njerëzve të dalin nga luftanë familjarëve të tyre shërbuesve publik që janë që punojnë në komunë, nxënësve të shkollave të mesme, njerëz me nevoja i kam me sociale faktikisht spakti janë përfshirë të gjitha kategoritë subvencionohen me këtë subvencionim. Është e vërtetë që besoj shumë që kanë pyetje dhe pse nuk po subvencionohet dhe fshatrat unë po dua me ja dhënë përgjigjen tash që mos me pyet pastaj. Dhe këta pensioniera që janë në fshatra kanë me ardhë në Prizren dhe kanë drejt me shfrytëzuar transportin urban. Domethënë në qoftë se vjem me autobus deri në bazhdarhane ose deri në stacion ka me mujt me shfrytëzuar me shku në shadervan, me shku te spitali apo kudo që është e nevojshme. Ajo e mira e së mirës kishte me qenë me u subvencionu dhe për fshatra, por mundësitë financiare nuk janë. Domethënë këtu ka mos për momentin ose besoj këtë periudhë do të subvencionohen vetëm transporti urban brenda qytetit. Ndërsa nëpër fshatra do ta shfrytëzojmë të drejtën edhe ata veteranë apo ata njerëz me nevojë sociale apo nxënësat do ta shfrytëzojnë të drejtën edhe brenda qytetit që do udhëtojnë. Kjo është hera e parë që mbas luftës po bëhet një gjë e tillë, unë s'besoj që është subvencionuar ndonjëherë transporti urban në në Prizren. Në qoftë se nuk di në qoftë se e dini ju mundeni me tregu ose mundeni me thënë që është subvencionuar po është lajm i mirë dhe besoj që këtë lajm duhet ta përkrahim këtë subvencionim duhet të gjithë, pavarësisht pozitë dhe opozitë ta përkrahin. Se është në të mirën e qytetarëve dhe njerëzve që kanë nevojë ta shfrytëzojnë transportin urban. Kjo e ka edhe efektin e vet se ekziston është mundësia që mos ta ndotin edhe ajrin dhe mos të bëjnë tullovi në komunikacion, që mund ta shfrytëzojnë transportin urban, mos t'i marrin veturat e veta dhe të kemi mundësi edhe lëvizjen më të lirë nëpër qytet. Diçka më tepër ka mundësinë edhe zyrtari që është i shërbimeve publike të elaborojë, që keni ndonjë pyetje shtesë. E kemi dërgu materialin, e keni marrë. Në qoftë se keni ndonjë pyetje për mua mundem me i'u përgjigjë, nuk besoj që ndoshta shumë duhet me më pyet, por duhet me thënë unanimisht krejt me votu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Për sqarime për këtë pikë. E kërkoi Iliri fjalën Baca Haziz.

Ilir Gashi (LVV): Shumë bukur e arsyetove nevojën, arsyeshmërinë, po sa kompani janë që merren me transport urban publik?

Islam Ukimeri: E ke fjalën në qytet?

Ilir Gashi (LVV): Po.

Islam Ukimeri: Për momentin s'është as një kompani se tash ne kemi me i shpall linjat. Kanë apliku edhe ai që e fiton është një kompani që po në momentin që e fiton që i marri linjat urbane që është një kompani, ai që e merr linjat urbane te drejtoria publike ai ka të drejtë të bëhet marrëveshje për subvencionim.

Ilir Gashi (LVV): Përfshin vetëm pikat urbane?

Islam Ukimeri: Absolut, unë e shpjegova.

Ilir Gashi (LVV): Periferi kurgjë nuk përfshin.

Islam Ukimeri: Ku funksionon urbani, deri në ato linja ku funksionon urbani, kanë me u subvencionu.

Ilir Gashi (LVV): A nuk është pak qasje përjashtuese kjo kështu.

Islam Ukimeri: Pse?

Shukri Quni (BDP): Katunart ti po i len anash.

Islam Ukimeri: Unë e spjegova shumë qartë para se me ma bë pyetje, ma marr mendja që keni me ma bë këtë pyetje.

Ilir Gashi (LVV): Edhe diçka a keni bë sa kilometra sa është një studim? Sa është kostoja për komunën, sa ka me dalë?

Islam Ukimeri: Nuk besoj se është shumë e madhe kostoja.

Perparim Shala: Afërsisht deri në 50,000 në muaj. Saktë nuk po them.

Ilir Gashi (LVV): A ka kushtëzime ato mjete që të jenë elektronike apo që nuk hargjojnë naftën, nuk e ndotin ambienti a ka këtu lloj kushte apo vetëm?

Islam Ukimeri: Po kushtet janë që është e caktuar euro gjashtë mos gabofsha ndërsa elektronike jemi pak më mbrapa ne duhet jo na duhet pak kohës elektronik me ble na duhet dhe buxhetin e qeverisë me marrë s'mundemi me atë.

Ilir Gashi (LVV): Tash pe di që është paragjykim po më shumë po më tingëllon si mbështetje për një kompani të caktuar private me 50.000 euro në muaj përafërsisht sesa me i bë shërbim qytetarëve në komunë.

Perparim Shala: Komuna e Prishtinës e ka 2.60 cent për kilometër.

Ilir Gashi (LVV): Po nuk janë më të mirë as ata, nuk e di, a po kupton.

Perparim Shala: 3.60 e ka që është e involvuar me elektrik. Domethënë pjesa ku tha që me pagu ose me ndihmu me 1€ e 20 cent në këto kilometër, që është si planifikim, nuk mundet pas shpenzimet ditore apo të naftës me i mbulu. Për shkak se ti po ja tërheq biletat që po i

subvencionon pensionerët për shembull. Nuk paguan pensionerë ti i'a jep 1.20€ për kilometër aty mund me hy për shembull 10-20 pensionera po e zëmë ja heq inkasimin po ja ndal, po me një farë forme po e shkel jo që po i ndihmoj po pak mund me me dëmtu si kompani.

Ilir Gashi: Sa kilometra në ditë i bën këto autobuset?

Perparim Shala: Afërsisht 20,30, 40, varet.

Ilir Gashi (LVV): Sa autobus janë që qarkullojnë në Prizren, sa janë me licencë?

Perparim Shala: 12 aktive.

Ilir Gashi (LVV): 12 janë aktive herë 20 km.

Islam Ukimeri: Nuk mundesh me e ditë saktë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Se ndoshta rritet kërkesa, në qoftë se bëhet subvencionimi rritet kërkesa e transportit.

Ilir Gashi (LVV): 200km, më mirë se ne Islami e din sa harxhon një autobus 1 km. Është dikund një litër.

Islam Ukimeri: Jo varet tash varet edhe prej mjetit. Dëgjo tash se në qytet kolonat më të mdhaja mandej kur të shkoh prej një destinacioni me një send 100 km kur nuk e ndal kërkon hiç ajo është matje origjinale.

Ilir Gashi (LVV): Sipas përlogaritjes time 11.000 euro, 11.00 euro diku po i bjen shpenzimet që mundet nëse janë të sakta ato që me i marrë me njëfarë masa. Ju që e dëmtoni atë kompani private, harrojeni. Që e dëmtoni buxhetin ton aty kam dyshime.

Islam Ukimeri: Ndëgjo se ta kemi një gjë parasysh. Në të gjithë Evropën bëhet subvencionimi i transportit publik bëhet. Edhe duhet me kanë shumë të lumtur që mund me bë mund me qëndru një transport publik duhet me subvencionu në mënyrë që subvencionojmë e diskutojmë dhe që jemi tu diskutuar dhe është qëllimi i takimit. Nuk mund me bë këtë matje po ja them unë një shembull nuk than original.

Ilir Gashi (LVV): Ne e dim Prizreni sa e ka perimetrin a po kupton?

Islam Ukimeri: Ka me u bë, është taografi në mënyrë elektronike që s'mundet me ndiku askush ajo në bazë të atë teografit ka me u bë pagesa. Është për, nuk mundet aty edhe kushdo me qenë me e marrë aty unë e di vetë se unë mirrem me transport vet edhe mund me dhënë shpjegim pak më të qartë. Qëllimi i transportit publik është për të mirën e qytetarëve arsye pse po them i qëndrueshëm transporti me këto kushte qysh është hyp nafti, po e shihni dhe vetë jeni shumë dëshmitarë që naftë e kalu 1.60-1.70 është litra naftit. Asnjë operator unë që kam linja për Prishtinë jam duke mendu një linjë me ndal me ndërpre. Nuk po ma qet sinqerisht po them, numri i udhëtarëve ka ra, për shkak që është ramja e numrit të udhëtarëve, shpenzimet janë inorme, shumë të mëdhaja edhe po duhet me ndërpre. Bile ne duhet me mendu, ndoshta kanë shumë më e mira udhës me mendu vitet e ardhshme qysh mundin edhe fshatrat për mos me pas edhe fshatrat me pas transport të sigurt fshatrat qysh kena mundur me arrit me subvencionu edhe operatorët që i mbajnë linjat nëpër fshatra. Domethënë vetëm transporti urban, nëpër fshatra ka transport privat që kanë

linja për shembull ka operator në pjesën e Hasit janë dy tre kompani që kanë linja për Hasë që 20-30 vite ne duhet me kqyr ata me arrit diqysh me i subvencionu për mos me u ndal ato linja. Unë po e shoh në Korishë po marr një shembull konkret në Korishë është një operator i ka pesë linja vetëm dy i mbajmë s'ka mundësi udhëtar s'ka mundësi financiare janë të asi dhe ne duhet me kqyrë nëpër fshatra qysh kena mundu. Aq më tepër këtu duhet me përkrah që me qenë transporti rentabil faktikisht me qenë edhe funksional mënyrën qysh duhet me i subvencionu. Tash mënyra e subvencionimit është bërë me kilometër ajo nuk ka me pas aty pak mos mendoni që kanë pas dyshime se është shumë mënyrë elektronike modelet e reja kanë elektronike nuk mundet askush aty me ndjekur në basë të kilometra atë ditës në fund të muajit bie te komisioni i veçantë që është kilometrazhit ka me u pagu aty nuk mund me hy në hak kërkush as mos me mendu diçka që ka dellavere. Bile unë besoj po foli si po e tha në aspektin kostoja. Unë mendoj që me 1.20 po më duket që bile është çmimi shumë i ulët, po foli si veç si biznesmen, s'po foli tash si drejtor, për transport është i ultë se nuk llogaritet vetëm nafta, duhet me pas parasysh, ne e llogaritim veç naftën, nuk llogaritet naftë.

Ilir Gashi (LVV): Me qenë transport lokal që i lidh të gjitha pjesët e komunës e vetëm pjesën urbane e kemi shumë qartë që shumica e arsimtarëve nuk kanë me pas nevojë, i kanë mjetet e veta, janë distancë ecjes, zjarrëfikësat, sa zjarrëfikës i ka Prizreni, domethënë i keni shti në disa kategori që mu duk si shërbim që bëhet për një shtres më të gjanë të popullatës. Por faktikisht nuk ka me pas të tillë që kanë me shfrytëzuar aq shumë ndoshta përveç pensionistëve. Si do të bëhet llogaritja a do të bëhet vetëm me kilometra apo me njerëz që kanë me marrë atë statusin e beneficuar si t'i themi asaj qysh ka me funksionuar, ka me pas biletë të veçantë?

Islam Ukimeri: Në atë moment po normal që ka me u bë identifikimin. Në atë moment që ka me u bë publike që subvencionohet transporti nga kjo datë, subvencionohet ka me qenë pa pagesë për kategoritë që janë të specifikuar në këtë arsytim që kemi dërguar po të premtoj jo vetëm arsimtarët jo vetëm zjarrfikësat por të gjithë ata që janë të përfshijnë këtë kategori këtë arsytim kanë me transport urban. Pse po premtoj se me këtë kosto që e kanë veturat po anë dizelli apo benzina nuk ka llogari kërkush edhe na që jemi kena me pas mund me ardhë me dalë për qef. Jeni tu e pa edhe vet jeni dëshmitar trafiku sa është i qetë tash jo tash është i qetë për shkak të kostës është me të vërtet shumë i qetë është unë jam tu habit edhe vet është shumë shpërlyer mundesh me vozitë nëpër qytet. Nuk ka si përpara hala duhet me ndal, kjo ndikon me ndal pse e ndal mësimdhënësit po mësuesit kanë me udhëtu pa pagesë nxënësat a din që ka dhe nxënësat që shkojnë me vetura. E kemi ba krejt pa pages, jemi tu mendu për qytetarin.

Ilir Gashi (LVV): Vetëm më trego si ka me u realizu pagesa.

Islam Ukimeri: Me kilometër.

Ilir Gashi (LVV): Amo me kilometër për të gjitha autobusat.

Islam Ukimeri: Të gjitha ato linjat urbane.

Ilir Gashi (LVV): Edhe mos me hyp zjarrfiksi apo polici, ushtari edhe mos me shfrytëzu ata kan me e pagu apo autobusin.

Islam Ukimeri: Kilometrat e transportit kanë me u pagu, për shkak se 90% e transportit ka me qenë pa pagesë.

Ilir Gashi (LVV): Atë desha me ditë.

Islam Ukimeri: Dë të thotë jo 90% domethënë a di çfarë është 10% në qoftë se një qytetar vjen prej Gjermanie apo prej një fshati tjetër apo një qyteti tjetër ka ardhë me nejt te ndonjë familjar i vet normal që e paguan, se s'është i komunës së Prizrenit, nuk ka identifikim.

Ilir Gashi (LVV): Na si komunë qysh e paguajmë kompaninë private.

Islam Ukimeri: Me kilometër.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ilir edhe këtu po ndërhyj pak, në qoftë se shtohet kërkesa edhe vetëdijësohet dhe gjithë ata që e shfrytëzojnë rritet kërkesa edhe në qoftë se tash janë 20 edhe për 10 autobuz të tjerë që është kërkesa, çka përfiton qyteti komunikacioni lehtësohet, çmimi i atyre që e shfrytëzojnë pse me shku me veturë deri në punë kur e ka çdo 10 minuta ndoshta dhe orari i transportit në qoftë se është në 30 minuta tash mundet kërkesa në 10 minuta me qarkullu në çdo lagje edhe unë edhe ti edhe të gjithë mund ta shfrytëzojmë trafikun pa pagesë.

Dafina Alishani (LVV): A bën me marrë fjalën se kam shumë pyetje?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, Dafina. Ndërhyra pak drejtor këtu po.

Haziz Hodaj (LDK): Unë deshta me marr fjalën.

Dafina Alishani (LVV): Më fal.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po për ju fjala Baca Haziz.

Haziz Hodaj (LDK): Jo s'jam pozitë këtu jam opozitë edhe shumë e fortë. Jo ky dallimi mes qytetit edhe fshatit ne e kemi vuajt me me shekuj i kanë vuajt të partë tanë. Po ja thashë jo absolutisht kjo nuk jo drejtor nuk bën nuk shkon unë nuk e votoj, nuk ka shans ose kur të bëni fushatë bëni veç nëpër qytet e nëpër fshatra mos delni. Sinqerisht po them nuk mundem me ju dal votuesve të mi përpara me ju thënë që është tu u subvencionu udhëtimi i nxënësve apo kategorive të tjera nëpër qytet, ndërsa ata që shpenzojnë më shumë marrë prej fshatit e në qytet, ata mbeten të diferencuar në këtë në këtë rast. Jo absolut jo jo nuk bën, nuk bën me me i nda, nëse s'keni mjete për të gjithë komunën e Prizrenit, mos hyni në këtë në këtë avanturë, keni mjete për me mbulu krejt, ju përgëzohet edhe e keni mbështetjen, përndryshe me i nda fshatin prej qytetit harroni që keni me pas votën time. Po unë kam kam me kërku edhe prej grupit mos me e votu absolutisht se unë po më vjen keq ti jeton vetë më duket jeton në fshat ose mobilizoje blema një banesë bile mos shkojmë që me ju dalur katundarëve përpara atje unë jam katundarë dhe mos të shkoj me ju dalë katundarë përpara me thënë ke votuar për qytetarët me enë pa pagesë se katundarët domethënë ky dallim nuk shkon, nuk është në kohë. Nëse nuk keni mjete me subvencionu të gjitha kategoritë edhe krejt komunës së Prizrenit, po ju lus mos hini në këtë avanturë, ti po kërkon unanimitet se e la që kjo punë është shumë e mirë, me i dallu qytetarët tash prej prej fshatarëve se dhe ata janë qytetarë të fshatrave. Kshtu që bën vaki më të qytetëruar janë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju drejtor.

Islam Ukimeri: Baca Haziz. Në qoftë se më keni dëgju më herët e kam marrë shembull e mora bile Hasin me tre operatorë në qoftë se më keni dëgju.

Haziz Hodaj (LDK): Po po, unë dëgjova shumë mirë shumë me vëmendje.

Islam Ukimeri: Thashë ne jemi tu e bë për brenda qytetit, po edhe të Hasit këta nxënës apo pensioner apo veteran apo qytetarë që vijnë deri në stacion të autobusëve dhe ata kanë me i shfrytëzuar pa pare me ardhë deri në spitale që e mora shembull apo deri në fakultet me shku studentit.

Haziz Hodaj (LDK): Studenti prej katundit shkojnë këmbë që kanë punë nuk e përdorin nuk e përdorin trafikun absolut.

Islam Ukimeri: Dëgjo e shfrytëzojnë.

Haziz Hodaj (LDK): Vet nuk e shfrytëzoj kur të vij me në autobus në spital me pas shkojnë në këmbë.

Islam Ukimeri: Paraprakisht para si e shpjegova e mora dhe shembull që ka me qenë kjo pyetje që është shumë e drejtë edhe e shpjegova mora shembull katër kompani që 20 vjet që punojnë që kanë linja për Has edhe ata kanë shumë pamundur e morra shembull edhe Korishën që është mundësia është janë duke u nal linjat për shkak të anës financiare s'ka me pas transport. Na si komunë duhet me parapar në të ardhmen në të ardhmen e afërt jo të largët sa më shpejt që me kqyr edhe këta operatorë privat edhe nëpër fshatra që me linja për mos me u nal, edhe edhe këto linja që kemi për fshatra na duhet neve për me i subvencionu për me bë linjat me pas.

Haziz Hodaj (LDK): Nëse nuk e shtin tash edhe atë jo. Unë votën nuk ta jap.

Islam Ukimeri: Ai është problemi juaj, unë kamë me i'u tregu qytetarëve të komunës se ju nuk jeni për me i përkrah këto. Ne nuk jemi duke thënë që s'kena me i subvencionu edhe nëpër fshatra, po me pas mundësi krejt jo nëpër fshatra, bile nga një pushim me ja siguru.

Haziz Hodaj (LDK): Po pse more po i dallon.

Islam Ukimeri: Po nuk jemi duke i dallu, nuk ka dallim, kanë me shfrytëzuar edhe qytetarët edhe katunarët këtë transport. Qysh çfarë dallimi ai vjen në bashdrahane hip prej këtu shkon deri në spital.

Haziz Hodaj (LDK): Ti subvencionoi ata me ardhë deri në stacion, prej stacionit mandej mos u brengos për ta.

Islam Ukimeri: Në krejt botën në krejt botën të transportit në qytet subvencionohet në krejt evropën keni dalë krejt unë jam kam në shtësi gjermane vetë personalisht jam shku në gjermani bile me subvencionon komplet për me kanë për me mujtë me qëndru transporti po duhet me subvencionu. Ama te na duhet me subvencionu transportin brenda qytetit me pas mundësi dhe nëpër fshatra pse jo. Ngadale ta bëjmë njëherë nëpër qytet ngadalëdale kena me shtirë rjetin me shku transporti urban në qoftë se nuk ka transport për shembull në Korishë kemi me obligu transportin urban me shku dhe në Korishë. Atë kilomet që e bjen ke me ja pagu, e morra shembull Korishën mos e mendoni që po them pak më afër ose në Has Gjonaj te katuni yt, kena me çu transportin urban Gjonaj ose Nashec e kam Lan Shukë afër. Ai transporti urban që vjen ka me u pagu.

Ilir Gashi (LVV): Me subvencionu më së pari fshatrat për qytet është shumë ma mirë.

Islam Ukimeri: Jo e ke gabim shumë, jo se në qytet nuk shkarkohet përkundrazi bjen më shumë. Pasi ta subvencionomë në katun kanë me ardhë gratë e katunit edhe djemt e katunit se e kanë pa pare transportit po vijnë tan ditën në shehër.

Dafina Alishani (LVV): Mirë se vinë. Se po më vjen keq me ardhë dita unë me mendu pjesën rurale më shumë se, jo është gabim.

Islam Ukimeri: Jo nuk e mendoni, unë e di si e mendoni ju. Po nuk je ti më katunarë se unë.

Dafina Alishani (LVV): Nuk po du me qenë ma katunarë se ti, veq po du me e pasë komuna një qasje gjithëpërfshirëse.

Islam Ukimeri: Po është gjithëpërfshirëse.

Dafina Alishani (LVV): Jo nuk është. Qe unë ta tregoj pse, unë në qytet me shfrytëzu transportin urban i paguaj 60 cent po ai prej Zhupës 6 euro po i shkon.

Islam Ukimeri: Nuk është e vërtetë. 50cent është bileta prej Korishës deri në Prizren, pse po thu.

Dafina Alishani (LVV): Jo 6 euro po i kushton.

Islam Ukimeri: Kur ke pagu 6euro? Nuk është e vërtetë, ne kemi transport nuk ka biletë 6 euro, për Prishtinë është 4 euro bileta.

Dafina Alishani (LVV): Pyetja ime e parë është kështu, unë para disa muajve kam bërë qasje për transport urban. Kam lypë kontratë të efa turisëm nuk më keni dhënë.

Islam Ukimeri: S'ka pasë kontratë.

Dafina Alishani (LVV): Veç pak, qysh s'ka kontratë për sa?

Islam Ukimeri: S'ka pas kontratë.

Dafina Alishani (LVV): E ki thirrjen publike, për çfarë afati e ka pas shfrytëzim?

Islam Ukimeri: Një vitë.

Dafina Alishani (LVV): Nuk kam marrë asnjë dokument.

Islam Ukimeri: Këto vazhdoen çdo vit. Edhe pse unë kam qenë për me bë pesë vjet.

Dafina Alishani (LVV): Tash ju po thoni që më së pari ka me u bë thirrja për transport urban.

Islam Ukimeri: është procedurë, është linja.

Dafina Alishani (LVV): Kompanitë nuk dihen apo jo?

Islam Ukimeri: Përzgjedhja është.

Dafina Alishani (LVV): Edhe tash ju a e keni një databazë domethënë? Këtu sa njerëz më së pari po e shfrytëzojnë transportin urban? A kemi ne më së pari me e pa sa përqindshi i qytetit po e shfrytëzon transportin urban? Sa qytetarë brenda një viti e kanë shfrytëzuar? Mandej nëse po duam

me e rritur shfrytëzimin e transportit urban, ish dashur me bë një kampanjë vetëdijësuese më së pari me i paralajmëru njerëzit që po bëhet një gjë e tillë prej komunës.

Përparim Shala: Po s'është tu bë nesër kjo.

Dafina Alishani (LVV): Qysh s'është duke u bë nesër.

Dafina Alishani (LVV): Pasnesër të votohet.

Islam Ukimeri: Me votuar njëherë në momentin që bëhet publike.

Dafina Alishani (LVV): Unë veç po du me ju lut diçka. Prioritet nëse është qytetari duhet mos me diskriminu askënd, edhe tash ju po thuani. Në anën tjetër edhe një pyetje e kam, kryetari në secilën media po del po thotë nuk kemi buxhet, ndërkohë na tash po bëjmë një avanturë, po fillojmë me subvencionu të gjitha kategoritë disa po diskriminohet, a kemi ne buxhet për këtë punë?

Islam Ukimeri: Nuk është kosto e madhe.

Dafina Alishani (LVV): Ani pse s'po e risim edhe në fshatra?

Islam Ukimeri: Po ne e kena bë para llogaritjen që kjo nuk na ndërlikon shumë buxhet.

Dafina Alishani (LVV): Propozimi im konkret është se ju po mendoni që ne veç pse jen opozitë po reagojmë ose po e kundërshtojmë. Propozimi im konkret është a bën ky subvencionim me filluar me fshatra mandej me vazhdu në urban, se prapë një njeri në pjesën urbane ma lehtë e ka me e ec që po thua ti prej stacionit deri në spital, ndoshta ja merr mendja me ec sesa ai që vjen prej pjesës periferike edhe që i kushton. Edhe ai e ka, e sheh më shumë, i duhet më shumë me ardhë në qytet sesa ai brenda qytetit që mundet me lëviz ndoshta edhe me një bicikëll, nëse e kemi hallin me shfrytëzuar transportin urban me e çliruar pak. Ose a mundeni edhe ju pak zyrtarëve me i thënë me i shfrytëzuar ato biciklat e komunës e mos me end prej administratës deri këtu nëse me të vërtet qenka halli i transportit. Më herët kanë një zyrtar vinte me i marrë nënshkrimet këtu në shpëpi të bardhë, interesant tash asnjë zyrtar s'po e shoh krejt nëpër kerre. Këndeje po ankoheni valla shtrenjt nafta, për krejt është shtrenjt nëse është halli me e çliruar trafikun.

Islam Ukimeri: Ta jap një shembull, në qoftë se e përfundove?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po për ju fjala

Islam Ukimeri: Ti tha që fshatrat përpara me u subvencionu. A e din ti që këtë pjesën e potgurit katër fshatra s'kanë transport fare.

Dafina Alishani (LVV): E di.

Islam Ukimeri: E mirë tash, a s'është diskriminim Korishës me i'a subvencionu transportin, Zhurit ose Hasit ndërsa Velezhë, Caparc, Shpenadi, Lutugllavë, Malësi e re, mos me subvencionu, çka me bë atyre katonarëve tash po them çka me ju bë? Më fal, çka me ju bë katunarëve që s'ka transport? Tash ata munden me thënë pse Korishës po i'a subvencionon. Katunari i Korishës ka me ardhë pa pare në Prizren, ndërsa Shpenadi, Velezhë, Malësi e re, Lutugllavë, 5-6 fshatra nuk kanë transport.

Dafina Alishani (LVV): Pse s'i keni shtuar.

Islam Ukimeri: E kena shtuar, po nuk po mbahen se s'ka mundësi buxhetore. Operatori që e kanë marrë linja kanë pas operatorë privat që kanë marrë linja mirë s'ka mundësi me mbajt atë linjë se nuk ka linja rentabile a po më kupton? Tash për me arrit në atë punë ne ngadalëdale kena me shtri rretin me transportin urban dhe nëpër këto fshatra ku nuk ka transport. Që i bjen, që ka me shku në atë fshat ka me u pagu me kilometra ka pas transportin gratis. Edhe në Korishë ka me ardhë transporti urban po edhe në Has ka me shku edhe në Zhurë, se ne kena me me shtri ngadal nuk domethënë që vetëm për Prizreni ka me pas edhe fshatra të tjerë Dardania, Lubizhda që është kuadër transportit urban ka u pagu. Ka me pas pa pagesë tash kena me çu transportin edhe në Caparc edhe në Malësi të re.

Haziz Hodaj (LDK): Ku ke linja të regjistruame që shkojnë qarkullojnë edhe nëpër fshatra ke mundësi me i subvencionuar. Ekziston mundësia, një kompani e merr mandej merren vesh në mesveti ata i pajis me kartela nxënësit apo cilat kategori ti do me i subvencionu, përndryshe kjo veç në qytet brenda unë them nuk të shkon, kjo nuk kalon.

Simir Krasniqi (Kryesues): Unë mendoj që kështu ne të fillon nisma me brenda në qytet këta do të punojnë edhe me bë zgjidhje dhe nëpër ato fshatra ku nuk ka linjat edhe me i subvencionu. E tha drejtori që kosto është shumë më e madhe nëpër fshatra edhe me mundësitë buxhetore këtë vit që ka komuna e Prizrenit me pa se si do të shkoj.

Islam Ukimeri: Atë subvencionim e gëzon edhe ky katunari i Korishës dhe i Hasit që vjen këtu.

Haziz Hodaj (LDK): Nuk e gëzon, unë konkretisht e kam nipin, një ditë babës vet 5 euro në ditë vijnë tha se 1.50 është bileta se 1.50 e kanë bë tash 3€ edhe një sandwich duhet me ble. Domethënë 5€ në ditë ai vjen deri në stacion prej stacionit në gjimnaz shkon në këmbë.

Islam Ukimeri: Pse po shkon në këmbë? Qdo 10 minuta ka me pas transport, pa ndërprerë.

Simir Krasniqi (Kryesues): E lëmë diskutimin edhe në kuvend.

Haziz Hodaj (LDK): Shumë mirë në rregull është shumë mirë kjo ka me të shkaktuar shumë probleme dhe shumë pakënaqësi.

Islam Ukimeri: Jo valla jo, ani e bëjmë na nëse na krijon neve pakënaqësi.

Haziz Hodaj (LDK): Unë s'po dua me e bë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe në kuvend ka me shku kjo pika.

Dafina Alishani (LVV): Jo, ta kuptojmë se unë duhet me ja shpjegu njerëzve sidomos grupit të kuvendarëve. Islam kqyre ty ndoshta të duket një komike po secili po du me pas këtë përgjegjësi se ti ke me pas ti duhesh më së pari me ju përgjigj votuesit edhe tash nëse të thirr dikush thotë unë ku jam a jam qytetari?

Islam Ukimeri: Do ta bëjmë edhe atje.

Dafina Alishani (LVV): Do ta bëj po a e din është, unë po them rekomandimi im konkret është filloni prej fshatrave edhe arsyeja i tham edhe Hazizi edhe unë, ata shpenzojnë më shumë për me ardhë këtu. E tash e kam edhe një pyetje ti hype nuk hype kompania e merr atë 1.5 apo?

Islam Ukimeri: Kilometrazhen po, se është free transporti. Duhet me qenë falenderues.

Dafina Alishani (LVV): Shumë faleminderit.

Islam Ukimeri: Po bravo, është arritje e madhe pse po bë transporti.

Dafina Alishani (LVV): Unë po e shoh si prioritet që e keni operatorin ekonomik, jo qytetarin, me pas pas qytetarin ish kon ndryshe, sinqerisht s'po e kuptoj këtë logjikë.

Trëndelinë Kastrati (PDK): Janë 12 në Prizren për shembull, qysh fillon ti e lënë qytetin tash fillon prej fshatrave.

Simir Krasniqi (Kryesues): Drejtori, duhet me bë zgjidhje edhe nëpër ato fshatra, po thotë shumë mirë, kur nuk ka transport.

Haziz Hodaj (LDK): Bëje zgjedhjen edhe për fshatra.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ne do të fillojmë me qytetin pjesa tjetër vjen e fshatrave, atëher e përcjellim në kuvend, debatin edhe në kuvend e kemi për këtë pikë.

Shukri Quni (BDP): Normal që e kemi debatin, por këto pika për shembull duhet me i diskutu edhe me i kuptu pak. A digjet dikush tash këtu me këtë projekt, a humb? Taksistat për shembull tash më nuk hipim në taksi, taksistat kanë me hup krejt. Një, e dyta, pensionistat e shkret një herë në muaj vjen këtu, këto krejt kanë me i shfrytëzu qëta që s'punojnë hiç, krejt paskan hy, krejt qytetarët. Pensionistat, kategoria e dalë nga lufta familjarët, me aftësi të kufizume, normal me qenë, pastaj policia, ushtria, zjarfikës, punëtorët e arsimit, shërbyer civil, kush ka mbet vëlla këtu pa hy këtu pa paguar. Dëgjo, në një fushatë 2012 se di sa ka qenë ishdrejtor i arsimit Nexhat Qoqaj se di çfarë viti ka qenë. Edhe në fushatë po propozon me ja dhënë i thotë kryetarit me ja dhënë punëtorëve të arsimit laptopa, normal fushatë. Se të gjithë kur bëhen punët e mira gjithë i ngre dikush thotë unë e kam propozuar thashë këqyre laptopa thash janë thashë material harxues. A ka mundësi se ishin rrogët e vogla atje, tash a kanë 2010, tani me nuk po e di, a ka mundësi thash me ja bërë pagesën të punëtorëve që janë, që punojnë nëpër fshatra. Edhe kryetari edhe ish kryetari, ai vetë ka punuar në arsim, ka udhëtuar për Gjakovë si profesor, deri kur ka dalë në pension. Tha shumë ide e mirë edhe u bë pagesa e arsimtarëve punëtorëve të arsimit në fshatra jo në qytet, sot bahet edhe në qytet. A e din që sot me bë me më thënë dikush me pas mundësinë e kisha ndaluar dhe i kisha thënë vetes pse e propozova. Ky djali ka vdek rahmet i pastë shpirti Parim Kosova Hazizi e din shumë mirë Pajtim a si e ka pas, ai e ka pas propozuar për me i heq shpenzimet e varrimit e ka propozuar në asamble sot po dalin plot jo unë e kam bë, ai e ka propozuar. Bile ne kemi qesh shumica, po ajo u bë shumë e mirë, janë do raste të cilat ja vlejnë votu edhe, janë disa që kjo nuk ja vlen more burrë. Nuk ja vlen që kjo me ju pagu secilit që ka biletë ose këto shpenzime. Në perëndim nuk e di që në perëndim e di që pensionera, njerëzit me aftësi të kufizuar i kanë të garantuar, po të flas për Berlin edhe ata duhet me shku kogja te mjeku me marrë një farë një farë dokumenti se nuk lënë. E me hyp çdo kush në autobus pa pagesë mos jemi këtu duke e tepru. Unë nxënësra bre, shkoj në drejtori të arsimit nxënësra nuk ja hek pagesën drejtorja arsimit 3 km 4 km udhëtojnë edhe duhet me plotësu një farë kriteri që nxënësra prej shtëpisë deri në shkollë duhet të vijë në këmbë nga 3 km nga 4 km, a tuten prej qenve a tuten prej kerrave. Kështu që të shkojmë disa gjëra të cilat ja vlenë edhe me votue edhe ti domethënë bën një sevap të madh për njerëzit që me të vërtetë e shfrytëzojnë. Vallah çfarë kategorie me hy sështë mirë nuk e di krejt tash me shku me hy në autobus pa pagesë pa marrë parasysh në fshat apo në qytet se nganjëherë na ka është

mirë nga njëherë edhe nga pak hajgare me bë, po unë i kisha heq këto për shkak të gjithë këta me e shfrytëzuar, çka bëjnë taksitët ose pompat e benzinës.

Islam Ukimeri: Dëgjo në qoftë se më lejohet kryesues.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po drejtor fjala për ju.

Islam Ukimeri: Sa i përket taksistave këqyre e drejta e secilit është del ma zotni me shku me taksim mos me hy në transport urban me marr taksin e paguan çmimin ndryshe. Nuk mundemi me ndal ne atë ose nuk mund me ja pamundësu mos me shku me taksim, është e vërtetë por mësuesi nuk e shfrytëzon taksin as pensionisti nuk e shfrytëzojnë taksin. Ata që e shfrytëzojnë taksin nuk i intereson hiç transporti urban, ndërsa ne për me për me u pajis me transport faktikisht me linjat me i marrim transportin urban janë disa kritere që është e përcaktuar edhe eurogjashtë për shkak të ndodhjes së ajrit në qytet.

Dafina Alishani (LVV): Cilat kritere?

Islam Ukimeri: Domethënë pajisa brendet e udhëtimit, është edhe një prej kritereve është eurogjashtë.

Dafina Alishani (LVV): Islam në këtë qytet jemi, autobuzat janë blerë pa u kryer thirrja publike.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mos dalim prej temës edhe pse e zgjatëm shumë këtë pikën se kjo shkon në kuvend.

Dafina Alishani (LVV): Mos bëni hajgare, autobuzat i ke pas të parkuar para se me u kryer thirrja publike.

Islam Ukimeri: A po don me të tregu drejt, në qoftë se kisha pas interes e kisha marrë unë.

Dafina Alishani (LVV): Tash nuk e di a ke pas interes apo jo. S'mundesh edhe gjithqka me mbajt.

Simir Krasniqi (Kryesues): Qëndrojmë në pikën e rendit të ditës.

Islam Ukimeri: Për me operu në qytet ka qenë edhe një kriter i eurogjashtë.

Dafina Alishani (LVV): Kush e ka kënd e ka shok ajo është kriteri.

Islam Ukimeri: Unë mendoj ndoshta është mirë që po po bisedohet edhe për fshatra unë mendoj që me faza të tjera me ngadalëdale me mund me i shti edhe fshatrat me i subvencionu. Por duhet me pas kriterin që ato kena me shti veç obligime ata transportues privat pse ai ka obligu me ble një autobus eurogjashtë me ble eurogjashtë është një kosto më e lartë, një autobus sun e blen duhet me ble dy tre autobuza nuk ka mundësi me ble, hipotetikiht ndoshta dhe ka mundësi por po e marr një shembull.

Dafina Alishani (LVV): Ju a jeni të vetëdijshëm çka keni bë. Ju keni bë thirrje për një javë keni lyp 10 autobusa cili biznes ka kapacitet.

Islam Ukimeri: Unë i kam 14 i kam vallahi 14.

Dafina Alishani (LVV): Unë me marrë punë katër vjet prej qeverisë.

Islam Ukimeri: Cilës qeveri?

Dafina Alishani (LVV): Komunale, ndaq ekskurziona.

Islam Ukimeri: Unë e marr qe 25 vjet ekskurziona.

Simir Krasniqi (Kryesues): Drejtor mos të dalim prej temës, qëndrojmë në pikën e rendit të ditës.

Islam Ukimeri: Na kena me kqyrë në fazat tjera, me i subvencionu edhe fshatrat, po veq kena me i shti obligime operatorëve privat me ble euro6.

Agnesa Sinanaj Gavazaj (LDK): Ani i shtin edhe fshatrat pastaj vjen edhe folë, kur kompletohet krejt.

Islam Ukimeri: Merreni barrë ju mos e votoni para qytetarëve që ju po e ndalni transportin urban, nuk po e subvenciononi. Unë po flas politikisht qka jeni duke bë. Asambleja është që të votohet kjo punë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ne i'a percjellim. Ne po e percjellim kuvend, kuvendi vendos aty.

Shukri Quni (BDP): Mos e kemi rastet sociale mos bëni hajgare, bëjani rrogën njerit edhe ta paguan autobuzin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Rrogat qeveria i bën.

Shukri Quni (BDP): Ani sot s'je në qeveri nesër je.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kur të vina në qeveria është diqka tjetër.

Shukri Quni (BDP): Pensionisti po e meriton kategoria e dalë prej lufte për qka nëse punon ai nëse s'punon e ka.

Islam Ukimeri: Ta kanë ndalu me ligj, ai veterani e ka 170 apo 200 sa e ka.

Simir Krasniqi (Kryesues): Baca Haziz po e percjellim në kuvend kemi mundësi me diskutu shumë më gjatë, aty vendosin edhe kuvendarët tjerë.

Islam Ukimeri: Unë thash se ti s'keje ktu dole jasht. Unë thash me fazat i shtimë edhe fshatrat në fazat e ardhshme, por kena me i shti në obligime operatorët.

Haziz Hodaj (LDK): Delni keq edhe vet.

Islam Ukimeri: Ne kena thënë që kemi me i bë edhe fazat tjera.

Simir Krasniqi (Kryesues): Baca Haziz po ja percjellim kuvendit, kuvendi vendos atje. Po ja percjellim kuvendit pikën e rendit të ditës mandej kuvendi vendos. E hedhim në votim për rekomandim të kuvendit.

Dafina Alishani (LVV): Kjo është qasje diskriminuese.

Simir Krasniqi (Kryesues): Tash Dafina e drejta juaj votoni, po e percjellim kuvend.

Dafina Alishani (LVV): S'ke qka i ndikon.

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo, po ne jemi në koalicion.

Dafina Alishani (LVV): Ani merri pesë minuta pauzë edhe dil fol me koalicionin, kjo nuk është në rregull kështu me i bë presion.

Islam Ukimeri: Asambleja vendos aty e keni fjalën.

Shukri Quni (BDP): Ti në asamble i ke votat. Kanë me i mshelë edhe kompanitë nëpër fshatra se ai s'ka llogari.

Islam Ukimeri: E qojm transportin na menjëherë, menjëherë transportin e qojmë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Drejtor kemi edhe pika të tjera të rendit të ditës. Baca Haziz po e percjellim në kuvend atë ditë e diskutojmë më gjerësisht.

Dafina Alishani (LVV): E pse po i bën presion njerit.

Simir Krasniqi (Kryesues): E percjellim në kuvend, mandej shohim në kuvend.

Haziz Hodaj (LDK): Unë po ju paralejmroj, ani percjellne në kuvend po votë unë kam me ja rekomandu grupit mos me votu.

Dafina Alishani (LVV): Për besë unë tash si të kryhet KPF-ja kam me i informu qytetarët kush ka pasë votë për, kush kundër.

Simir Krasniqi (Kryesues): E drejta juaj është ajo me bë politikë.

Haziz Hodaj (LDK): Unë e jap qendrimin tem, jam i panvarur.

Dafina Alishani (LVV): Po e shoh sa je i pavarur, njeri që tre herë po të bën presion po thotë po e percjellim në kuvend. Tri herë të tha Baci Haziz e percjellim në kuvend tani e diskutojmë.

Haziz Hodaj (LDK): I ke hy kësaj kësaj avantur, hyni por delni në skej.

Islam Ukimeri: Pse unë jam kthy mbrapa najherë, në qoftë se kam obligim unë te katunarët kam unë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Drejtor mos ta zgjasim shumë e percjellim në kuvend. Sa jemi për ta percjellim në kuvend.

Haziz Hodaj (LDK): E shohim mbasnesër në kuvend, se në kuvend votohet kjo. Kjo është ktu formalitet.

Dafina Alishani (LVV): Baca Haziz nëse hyn në rend dite e patë kjo punë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Sa jemi për? 4 jemi për. Kundër? 4. Atëherë kjo pikë i rekomandohet se vota dyfishtë është e kryesuesit, kjo pikë i rekomandohet kuvendit. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për subvencionimin e transportit urban, i rekomandohet kuvendit për mbledhën e radhës.

Dafina Alishani (LVV): Qe ku e ki procesverbalin, njeri foli 15 minuta kundër, me presion të kryesuesit, e çoj dorën.

Haziz Hodaj (LDK): Nuk kesh kundër por kërkova, kërkova në program me hy edhe fshatrat. Nuk hyjnë fshatrat nuk ka votë në kuvend, ti thirre konferencën për shtyp.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kalojmë te pika e pestë e rendit të ditës.

Haziz Hodaj (LDK): Kryesues edhe njëherë po them sinqerisht për fjalë, nuk hyjnë të gjitha kategorit me u subvencionu edhe fshatrat edhe qytetet nuk keni votë po ju kallëzoi mos thoni mandej e dita se dita.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kalojmë te pika e pestë e rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001-01/25151 të datës 26/2/2026 për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2026 sipas kërkesës së MAPL-së. Drejtor a ju apo zoti Gursel don me bë prezantimin e pikës.

Islam Ukimeri: A mund me na leju kam një takim tjetër?

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, drejtor. Përparimi mundet me nejtë këto pikat e fundit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ditën e mirë faleminderit për sqarime kaloni mirë ju. Drejtor fjala për ju?

Elsabah Xhurxhehalo: ... për në komitetin e juaj për tu rekomanduar për seancën e radhës vendimin ashtu qysh e keni lexuar edhe ju. Materialin po besoj se e keni marrë kohë të gjithë, është vendimi i njëjtë me atë të seancës që është mbajti në muajin shkurt. E cila në aspektin e ligjshmërisë është kthyer nga MAPL-ja duke pasur disa kërkesa të cilin po ashtu edhe vendimin e MAPL-së e kemi bashkë me arsyetim. Ne gjatë kësaj periudhe kohore tashmë si drejtori kemi bërë përpjekje për me organizuar një takim me zyrtarët e MAPL-së të cilët kanë marrë këtë vendim edhe të cilët në vendim kanë shprehur gatishmëri për me bashkëpunu me neve në mënyrë që me e rregulluar këtë propozim vendim. Por deri në këto momente kur po flasim nuk kemi marrë përgjigje prej tyre për një takim eventual, po flasim për nivelin e shërbyesit civil, ku zyrtarët që janë shërbyes civil tashmë të kësaj drejtorie kanë komunikuar me shkrim me zyrtarë që janë po ashtu shërbyes civil të ministrisë në kuadër të detyrës zyrtare. Kemi bërë përpjekje edhe përmes telefonit me i kontaktuar, dhe deri në këtë moment nuk kemi asnjë përgjigje, atëherë, domethënë kemi shkuar me mënyrën e hulumtimit se si është në komuna të tjera dhe nga ato çka kemi marrë prej shembull nga të gjitha komunat e tjera përfaqësues të gjitha komunat e tjera të Kosovës edhe e kemi integruar ndryshimet ashtu të cilat janë të MAPL në këtë propozim vendim të cilin e kemi të dëguar sot. Më lejoni t'ju njoftoj që në aspektin përmbajtësor të kërkesave nga ajo që është kthyer prej vendimit MAPL-së, të gjitha kanë qenë edhe në propozimin paraprak, mirëpo kjo nga MAPL që është kërkuar tash, ne konsiderojmë që është më shumë në aspektin teknik, ata kanë kërkuar që në listën e pronave në tabela të integrohen ato përshkrime, njoftime, ashtu qysh e keni edhe te materiali, ndërsa në propozimin që ka ardhur më herët në kuvend, e cila edhe është votuar dhe është diskutuar, është në një farë forme dhe është diskutimi i arsyeshmërisë se pse kjo duhet me ndodhë. Ka qenë në propozim vendim si pikë shtesë, ndërsa na tash e kemi marrë prej aty edhe i kemi vendosur në këto tabela që kemi marrë si print ja të dy faqe për me e pa, domethënë kemi shtuar këto kolonat dhe i kemi vendosur aty. Pra ndryshimi që është bërë nga ana jonë është në aspektin

teknik, e konsideroj që është në aspekt teknik dhe jo përmbajtësor, sepse kështu e konsiderojmë edhe kërkesën që është, që ka ardhur nga MAPL, që kërkohet të bëhet ndryshimi teknik, pasi që edhe në propozimin e kaluar që e kanë bërë sektori, të gjitha kërkesat që i ka MAPL-ja me këtë vendimin e vet nga ana jonë kanë qenë aty por kanë qenë te propozim vendimi dhe jo te tabelat. Tash është kërku që edhe te tabelat e secila ku që është në listën e veçantë të vendosen ato dhe ne i kemi vendosur edhe e kemi sjellë pranë jush, me të cilin kërkujmë që këtë pikë ta rekomandoni për të marrë pjesë në rendin e ditës në seancën e radhës të kuvendit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor, për sqarime, e hapim debatin, don dikush ta merr fjalën, po Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Edhe në seancën që e patëm, kur u votua kjo pikë, vërejtja nga ana jonë ishte që afati i fundit për me i kaluar pronat që mendohet me i dhënë në shfrytëzim është 31 dhjetori për vitin vijues dhe këtu na u tha atëherë që është marrë një miratim verbal prej ministrisë, po tash në katër pikat vërejtje që i ka dhënë nga MAPL-ja, njëra prej tyre ishte kjo teknike që mungonte numri i parcelës, për shembull afati kur, afati për sa kohë duhet me u dhënë në shfrytëzim, ato janë plotësuar. Vërejtja e parë ishte që afati për dhënie, në shfrytëzim pronave që duhet të jenë të miratohen parapraktisht është 31 dhjetor, sërish shumë qartë ishte cekur aty dhe në vendimin që e ka përgatitur që është përgatitur në emër të kryetarit aty shkruhet se për vitin vijues 2026 nëse thua viti vijues 2026 nuk ka kuptim sepse viti vijues është viti që vjen pas viti i ardhshëm është viti në vazhdim mundesh me thënë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ndonjë lëshim teknik këtu nuk është diçka se ne ja kemi përcjellë.

Ilir Gashi (LVV): Vërejtja e parë e MAPL-së është për datën 31 dhjetor, nëse kjo qëndron atëherë ne nuk mund.

Simir Krasniqi (Kryesues): Na kanë zgjat afatin, për arsyeja e qëllimit i zgjadhjeve.

Ilir Gashi (LVV): Aty shumë qartë po shkruan.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vetëm me tabelën kanë pas.

Elsabah Xhurxhehalo: Nëse e ke kry, domethënë, këtu e kam edhe Gurselin që mundet më detajisht me ju spjegu lidhur me këto, por domethënë sa i përket kësaj çfarë po lexoni, nuk janë katër vrejthe, domethënë janë dy pika që janë cituar në këtë vendim nga MAPL-ja, ku të njëjtat janë të cituara në fazën e parë njëshi dyshi është cituar prej ligjit dhe e dyta prej rregullores domethënë nuk janë katër vërrejtje realisht janë dy pika që në arsyetim se për çka nuk përputhet me ligjshmëri e ka cek ato. Nëse po supozojmë tash ju shpjegon Gurseli këtë punën që e tha edhe kryesuesit që kanë marrë domethënë shpjegim lidhur me afatin që pse nuk është 31 dhjetor por ka shkuar deri më vonë. Por sa i përket 31 dhjetor këto isha domethënë nëse do të ishte 31 dhjetor atëherë MAPL-ja neve nuk do të na kishte dhënë 30 ditë afat për me i integru këto që po i kërkon me i korrigju me këto vendime me i marrë veprimet e duhura domethënë do të kishte me e shpall këto të pavlefshëm dhe të pamundshëm për me mund me vazhdu më tutje.

Ilir Gashi (LVV): Ai ty po të jep mundësi për vitin vijues domethënë për vitin 2027, por kur duhet viti vijues atë kuptim e ka viti i ardhëm.

Elsabah Xhurxhehalo: jo jo është është fjala për vitin 2026 domethënë edhe te vendimi këtu ku e ka cituar te faqja e parë.

Iilir Gashi (LVV): Po kur thot viti vijues është viti i ardhshëm, edhe një muaj afat kanë kalu sepse vendimi është me 17 mars mos gabofsha ne sot jemi 26 apo 27.

Elsabah Xhurxhehalo: Po ne sot jemi propozimi propozimi është bë.

Iilir Gashi (LVV): Një muaj veç ka skaduar afati.

Elsabah Xhurxhehalo: Me sot mundet me skaduar po brenda 30 ditëve nga ne ka kërkuar që të marrim veprimet e nevojshme. Na që jemi propozues që jemi inicues apo autoritet i cili duhet me i përgatitur këto me inkorporu ne kemi bërë këtë inkorporim brenda afatit 30 ditor dhe e kemi dërguar për procedim më tutjeshëm. Domethënë caktimin e seancës këtu edhe për këto çështje të tjera nuk munden ata me bë sipas MAPL-së për një vendim kur ka edhe shumë vendime të tjera.

Iilir Gashi (LVV): Unë me sa e kuptova.

Elsabah Xhurxhehalo: se po të mes borxh edhe për pjesën e pyetjes së parë, domethënë për 31 dhjetor, Gursel nëse ki mundësi me e shpjeguar pse nuk është.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ja kemi përcjellë shtyrjen e afatit, vendimin.

Gursel Skenderi: Këtu domethënë këto pikat një edhe dy nuk janë vrejte po domethënë po e citon ligji çka thotë. Edhe gjatë kohës domethënë sa herë kemi unë edhe para dy muajve ju thash sa herë kemi zgjedhje lokale domethënë gjithmonë qeveria e shtyn afatin për tre muaj deri në 31 maj, domethënë edhe jemi brenda afatit. Po këto nuk janë vërejtje, këto po e citon ligji dhe rregullorja çka thotë, edhe qysh tha drejtori mos e përsërit ne gjashtë vite domethënë e kemi pas ato çka i ka kërkuar ministria i kemi pas në propozimvendim, mirëpo që tash që tash po du me inkorporuar tabela dhe i kemi bërë kemi kërku takim me shkim nuk janë lajmëruar, me telefon zyrtar nuk janë lajmëruar, me telefon privat nuk janë lajmëruar, mandej përmes një shokit ka thënë bëne sikur Mitrovica.

Dafina Alishani (LVV): Gursel i kanë heq ata zyrtarë që bashkëpunonit dhe që i futnit pa detaje. Unë po të kallëzoh që i kanë heq, prej tregut fatoni, prej asaj marrëveshje që e keni pas me zyrtarin, tre zyrtarë janë larguar prej MAPL-së, ata zyrtarë të cilët juve ju kanë mbyll sytë për këto lëshime. Kur është sjellë kjo pika me u votu vetë këto citime unë prej ligjit ju kam bë juve se drejtori s'ka faj drejtori tash ka ardh por ju si zyrtarë shumëvjeçar. Prit bre ta kryej si zyrtar shumëvjeçar ky ligj nuk është tash ligj i ri, nuk është diçka që është kërkuar tash, destinimi, periudha kur hipet prona ka qenë gjithmonë po ju keni shfrytëzu vakumin ku keni pas kontakte personale me disa zyrtarë aty edhe keni arritur me i shty disa lista të cilat nuk kanë qenë në rregull me ligj edhe tash po quditeni qysh po kthehet kjo. Të njëjtat rekomandime që i ka MAPL-ja, a ti kam thënë këtu në KPF vetë personalisht, a ti kam kërku një nga një këto që t'i ka thënë tash MAPL-ja, pse bre Gursel po na shtini me bë punë ka tri herë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, jemi edhe shumë komuna të tjera ja u kanë kthy mbrapsht nuk është vetëm komuna e Prizrenit.

Gursel Skenderi: Dafina a mundem një informat me ju thënë, ne kemi kontaktuar me Donjeta domethënë me Donjeta Cakollin tash çka është, jo me ish çka thatë ju edhe domethënë përmes telefonit. E ju çka i keni thënë është e vërtetë nuk po e mohoj por në propozim vendim Dafina janë qenë ai këto ju çka e kam thënë edhe zyrtarët gjashtë vite e ka pa edhe drejtori domethënë kështu ka shkuar propozim vendimi prej 2020.

Simir Krasniqi (Kryesues): Janë edhe shumë komuna që jau ka kthyer mbrapsht nuk jemi vetëm si komunë.

Elsabah Xhurxhehalo: Domethënë meqenëse është një temë lidhur me të cilën përmbajtjen e të cilës diskutimi ka ndodhur edhe në seancën e muajit shkurtë, këto pretendime që po i thotë, në këtë rast Dafina për lidhje personale, për këto personalizime të sende, domethënë, po mendoj që në takime të tilla duheni me i ndërhy edhe me i ndërpre, sepse nuk kanë bazë, nuk kanë fakte, nuk kanë elemente pse ata i kanë larguar dikë prej diku, nuk po e di për herë të parë pos e ndëgjoj. Nuk përbën bazë për me dalë dikush sidomos në këtë lloj takime edhe me pretendu që ata njerëzit e tu e këta njerëzit e tonë se unë jo rastësisht thashë ata janë shërbyer civil. Domethënë ata kanë një akt emërim të punës, ne në këtë moment jemi staf politik, po ata janë shërbues civil, Gurseli është shërbues civil, nuk është jemi asi kësaj as i dikujt tjetër dhe në momentin e caktuar kur është një kërkesë pranë Gurselit duhet me pas përgjigje. Në momentin kur pranë një zyrtari e ministrisë është një kërkesë, duhet me pas një përgjigje edhe ata atje e kanë një hierarki ne nuk e dimë për çfarë arsye i kanë heq po Dafina po e dika po ne nuk po e dimë. Veprimin çka ne kemi bërë si drejtori është, kemi shiku vendimin që na ka ardhë prej MAPL-së, zyrtarët, shërbyes civil që janë nënshkruar në këtë vendimin që na ka ardhë prej MAPL-së dhe ju kemi drejtuar këtyre zyrtarëve pasi që ata në vendim në fund thonë që MAPL mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim. Unë e uroj që edhe ndaj këtyre zyrtarëve të zhvillohet procedurë, sepse këta kanë thënë që janë në dispozicion, ne ju kemi shkruar, me shkrim ju kemi drejtuar brenda afatit shumë të shpejt kohor dhe nuk kena marrë përgjigje, domethënë nuk ju ka ndejt gati vendimit vet që e kanë çu, nuk janë në dispozicionin tonë, ndoshta janë të dikujt tjetër, për të tonin jo. Kështu që kisha pas dëshirë që të eliminojmë këto gjëra sepse unë nuk e di njeri kujt, kush është, ku është, ne kemi bërë një përpjekje, kam ardhur me sinqeritet me treguar që kemi qenë të gatshëm për me shkuar ne në Prishtinë me i taku ata edhe me na treguar qysh sepse kemi zhvilluar edhe me zyrtarin ligjor këtu takim lidhur me ato se nëse e ka kuptuar se si duhet me u inkorporuar kjo. Nuk kemi mund me mbërri në rezultat atëherë kemi shku me mostrim kemi marrë si kanë bërë komuna të tjera ashtu i kemi integruar ne. Atëherë kur këta kanë bërë në vitet e kaluar forma e njëjtë ka kalu ligji po thoni ka qenë i njëjtë nuk ka ndryshuar asgjë, atëherë ka kaluar tash s'ka kaluar. Duhet në marrëdhënie individuale, nuk e di, as nuk jo, kështu që ne e kemi sjellë me këtë, e kemi, domethënë, qëllimin e sinqertë, punën e kemi bërë pa marrë parasysh se kush është tek është, kemi bërë përpjekje për me i kontakti nuk kemi mund dhe po besoj që kjo në këtë formë ka me na u kthyer pozitive në aspektin e ligjshmërisë pasi nëse edhe votohet në asamble.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë e hedhim në votim që të ja rekomandojmë.

Dafina Alishani (LVV): A bën veq pak?

Simir Krasniqi (Kryesues): Dafina, shkon edhe në kuvend, çdo pikë se e zgjatëm goxha shumë se kemi dhe pika tjera.

Dafina Alishani (LVV): Duhet me u diskutu, për këtë punë jemi na. A ke punë tjetër?

Simir Krasniqi (Kryesues): Jo, këto pika kanë me shku edhe në kuvend.

Dafina Alishani (LVV): Unë e kam obligim si antare KPF-së me i sqaru me grupin tim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë atëherë fjala për ju.

Dafina Alishani (LVV): Domethënë na këtë edhe njëherë po e përsëris, aludimet e gjërat individuale çka janë unë besoj që për që tash prej mandatit që ju e keni marrë mundeni me fol. Po mirë është edhe si drejtor i pronave me bë një skanim të pronave dhe me pa qysh janë dhënë pronat komunale, ti ke pronë me metra katrorë shumë të larta që paguhet 400 euro për muaj qiraja, e ka të hyra 80.000€ ti duhesh këto me ditë shumë mirë. E tash këto kur është për nguti neve na ka ardhur Gurseli pavarësisht që është shërbyes civil edhe na ka thënë që gjithçka është në rregull, obligimi jem nuk është me e parë a është në rregull a jo, ky e ka atë detyrë me prona me u marrë apo jo? Destinimi tash edhe kjo mendoj që se di qysh mundemi ne me i futur të gjitha pronat me një destinim të caktuar edhe me një emërtim të caktuar. A nuk ishte më mirë për shembull për këtë vit me i pas kaq prona të planifikuara me u dhënë në shfrytëzim, se kjo po më duket pak a din veç për me bë proceduralisht po i fusim të gjitha me një kategori, mua veç po më vjen keq që rekomandimet nuk po merren parasysh edhe po ja humbim kohën pastaj kuvendit se po kthehet negativisht.

Elsabah Xhurxhehalo: E nderuar çështja e qëllimit destinimit që e kemi cekur ne sipas hartës zonale kadastrale të komunës, rritja e vlerës të pronës komunale dhe të hyrave, ky është një term i përgjithshëm ashtu që e keni parë që e kanë të gjitha pronat, pse? Sepse na as si drejtori nuk mundemi me e caktuar destinimin e një prone në një vend, sepse këtu janë të futur me prona të luajtshme edhe të paluajtshme, domethënë objekte edhe toka si prona të paluajtshme dhe nëse një hapësirë është e destinuar për ndërtim të lartë po supozoj apo është e destinuar vetëm për bujqësi apo për diçka tjetër unë nuk mund me ia caktuar këtu që me u bë aty me u mundësu aty ndërtimi i ndonjë objekti për prodhimtari apo diçka tjetër. Sepse është një dokument tjetër i cili e përcakton destinimin e secilës zonë brenda komunës së Prizrenit, po ashtu duke u bazuar që edhe komuna të tjera e kanë shfrytëzuar këtë term, për ne na është duk e logjikshme që të vendosim edhe ne këtë term sepse pastaj ju e dini ndoshta më mirë prej viteve të kalume, që atëherë kur ka kërkesa dhe kur futet në procedurë një pronë për me u dhënë në shfrytëzim, atëhere edhe këto parametra se varësisht se sa çka lejon harta zonale, çka lejon me u ndërtu apo me u punu, përpunuar në atë tokë e përcakton një dokument tjetër dhe komisioni i cili vazhdon me vepru me këto, pastaj duhet me pas parasysh atë dokument tjetër. Nëse na e destinojmë po besoj që hyjmë ndërhyjmë në punën e dikujt tjetër është edhe kjo pika e datës së publikimit të njoftimit, në të cilin kemi përdorur ne një term të përgjithshëm, pasi që ju e dini që pas propozimit në kuvend formohet komisioni i cili komision e ka për detyrë pastaj me i zhvilluar procedurat dhe brenda asaj me bë edhe shpalljen e datës. Ne si drejtori nuk kena mundur këtu me caktuar që ky grupi i pronave ka me u dalë në gusht që grupi i pronave ka me u dalë në shtator, prandaj i kemi përdorur këtë term të përgjithshëm që nuk bie në kundërshtim me asnjëri prej veprimeve të ardhshme, po edhe është një lloj destinimi. A do të kishte me qenë idealja, që me u pas një studim të mirë të qartë brenda gjithë këtyre qindra pronave apo mijëra pronave me u përcaktuar secili është po. Por për këtë punë lypen kapacitete shumë më të mëdhaja, unë po besoj që kryetari me formimin e drejtorisë me shkëputjen nga sektori në drejtori të kësaj njësie dhe çka bë një hap më tutje që të kemi punë më profesionale të kemi një punë më mirë të planifikuar. A do të jetë për vitin e ardhshëm më mirë e planifikuar sigurisht, po se në çfarë forme do të jetë ato do të na tregon puna që kena me bërë gjatë këtij viti.

Dafina Alishani (LVV): A janë edhe zona ekonomike e përfshira në listë?

Elsabah Xhurrhehalo: Kjo është të gjitha pronat çka komuna i ka në listën e përgjithshme sepse çështjen nuk kemi prekur ne në esencën e asaj çka është votuar në seancën e kaluar atëherë i kemi lënë ashtu dhe të gjitha pronat që i posedon komuna e Prizrenit janë të futur edhe në listën e veçantë pasi që gjatë vitit ne nuk e kemi me paragjyku apo me paraplanifikuar se për çfarë lloj prone, çfarë lloj këtë pjese për çfarë lloj shfrytëzimi mundet me ardhë, andaj e kemi vendosur në listën e veçantë, ashtu është vendosur në listën e veçantë dhe ka kaluar në mënyrë që me i hapur rrugë që për çfarëdo lloj kërkesë që mundet me ardhë normal e arsyeshme në aspektin ligjor të jetë e mundur që të vazhdohet më tutje me procedurat. E procedurat ju e dini më mirë se cilat janë pastaj ato që zhvillohen në kuvend dhe pas kuvendit në komisionin e caktuar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për sqarime. E hedhim në votim që kjo pikë, pika e pestë e rendit të ditës t'i rekomandohet kuvendit pra në mbledhjen e radhës që do të mbahet ditën e enjte. Sa jemi për? 6 jemi për. Kundër 2? Abstenime nuk ka dhe pika e pestë e rendit të ditës shqyrtimi dhe miratimi i propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001-011/25151 të datës 26/2/2026 për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të palujtshme të komunës që planifikohet për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2026 sipas kërkesës së MAPL-së i rekomandohet kuvendit për mbledhjen e radhës pra që do të mbahet ditën e enjte më 30.04. Kalojmë te pika e gjashtë shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës në drejtorinë komunale të arsimit. E kemi drejtoreshën këtu, mund ta bëni prezantim në shkurtër, faleminderit.

Luljeta Veselaj Gutaj: Faleminderit kryesues të nderuar kolegë asambleistë, drejtoria komunalë e arsimit në Prizren në bazë të nenit 12, paragrafit 2, shkronjës d të ligjit numër L-03-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 14, paragrafi 8, pika 8.1 të rregullores numër 90/2024 për procedurat e përzgjedhjes së emrimit të drejtorëve, zëvendësdrejtorëve, mësimdhënës, bashkëpunëtorë profesional, asistent, instruktor dhe sekretar në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar. Si dhe nenit 27 të paragrafit 1 të statutit të komunës së Prizrenit me numër 01 011/5643 të datës 15 tetor 2008. Drejtoria komunale e Arsimit në Prizren i propozon Kuvendit të komunës të marrë vendim për formimin e komisionit përzgjedhës. Komisioni përzgjedhës është i përbërë, do të thotë formohet. për testimin, intervistimin e kandidatëve për konkurim, i cili do të shpallet sipas afateve ligjore për pozitën e lira, të cilat janë për drejtor, zëvendësdrejtor në institucionet publike arsimore në komunën e Prizrenit. Përbërja e komisionit është sipas rregullores, e cila është në fuqi, është një anëtar për secilin komision, është një zyrtar i drejtorisë së arsimit, është një ekspert i arsimit dhe një anëtar i komisionit vjen nga ministria e arsimit, kur ne e hapim thirrjen për konkurs dhe njoftojmë ministrinë e arsimit atëherë e delegojmë. Përbërja e parë është Nexhat Maçkaj zyrtar në DKA, Afërdita Qollaku, eksperte e pavarur e arsimit dhe një anëtar nga MASHTI. Komisioni i dytë është Haxhere Gavazaj zyrtare në drejtori të arsimit, Shemsi Morina, ekspert i pavarur i arsimit i cili është edhe profesor universitar dhe një anëtar nga MASHTI. Dhe komisioni i tretë i cili ka të bëjë më shumë me komunitetet, komunitetin turk edhe boshnjak, është Ferdi zyrtar në drejtori të arsimit, Alija Biliban ekspert i pavarur dhe një anëtar i cili do të vjen nga MASHTI. Janë edhe neni dy tre dhe katër që besoj i keni lexu për mos me ja u marrë kohën shumë, po ashtu i kam përcjellë, kryesuesi i ka përcjellë edhe civilin e secilit anëtar të komisionit. Kërkoj mbështetjen për këtë komision për të proceduar më tutje për të hapur thirrjen për konkurs për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoreshë për sqarime. A kemi diskutime? Që nuk kemi e heshim në votim që t'ja rekomandojmë kuvendit.

Shukri Quni (BDP): Ti e din që ky komision ta ka rrëzu prej pushtetit Mytaher Haskukën, ti vet ke qenë në asamble a e din. Katër pika nuk e kemi votuar ne Mytaher Haskukën komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve ka vazhduar me katër vjet ushtrues detyre. Kur ju po vini në pushtet edhe po merrni pozita shumë shpejt po i harroni atje disa gjëra edhe shumë po i merrni me në nguti nuk e di për çka kush po i jep atij kaq stres. Ne sot jemi qenë jemi të përgatitur të gjithë në ora 10 me ardhë në mbledhje, sa zgjat mbledhja, sa ne e kemi të arsyeshme me diskutu. Se e pash edhe drejtori e kishte marrë me hez shumë, ky i shërbimeve publike. Unë e di që këto kalojnë prej këtu prej KPF-së edhe diskutohen në asamble atje, po mos me i diskutu na pikat e vetëm me i votu nuk është mirë, kryesues. Mos me i marrë shumë gjërat me hez me i kuptu pak më thjeshtë. Mos them me stres ose ngarkesë që duhet me kalu, po s'kalon s'bëhet kiameti punë e madhe. Për ata mora shembull që ky komision do të thotë Mytaher Haskuka ku ka shku nëpër televizioni e ka cekur edhe ty të ka akuzu mua tjetrin kuvendarët janë ata të cilët i ka akuzuar, kuvendarët i ka fajësuar të gjithë. Po unë këtu nuk e kam të qartë, mandati i komisionit përzgjedhës përfundon me nxjerjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit në pozitën e kërkuar në konkurs. Mandati i këtij komisioni një vjeçar ka qenë sa e di unë.

Luljeta Veselaj Gutaj: Po nëse muj me dhënë sqarim. Mandati me udhëzimin e vitit 2020 udhëzimin paraprak ka qenë për një vit shkollor mandati i komisionit, do të thotë për secilën pozitë që është hapur ose dikush ka liruar pozitën e ushtruesit drejtorit ose zëvendësdrejtorit ka mundur me ushtruar atë mandat ai komision, kurse me rregulloren e fundit e cila është me numër 19/2024, tani mandati është vetëm për atë grupacion të pozita që përfundon me nxjerjen e vendimeve fituesit ose jo fituesit me listën përfundimtare. Dhe aty prapë nëse kemi pozita të lira prapë duhet votohet komisioni po me të njëjtat procedura, unë mendoj që në grupin punuar se ku është punuar rregullorja kanë dilema se edhe në ministri ka dilema do të thotë ka ik me diçka ose është mendu me u bë më mirë po është komplikuar se ka pas shumë reagime po aktualisht është kështu. Deri të bëhet një plotësim ndryshim është duke u punuar në plotësim ndryshimin e udhëzimit edhe rregullores besoj në momentin që na vjen atëherë edhe ne i ndryshojmë edhe formate të tjera të cilat i procedojmë. Aktualisht është vetëm për një thirrje që hapet nëse supozoj i kemi 10 pozita për drejtor, në momentin që përfundojnë krejt procesi i konkursit shpallet lista fituese, përfundon mandati i këtyre komisioneve dhe duhet prapë të inicohen procedura të reja.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoreshë, a kemi diskutime të tjera? Atëherë që nuk kemi e hedhim në votim, sa jeni për që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet kuvendit? Gjashtë jemi për, kundër? Dy kundër, abstenim nuk ka. Atëherë, pika e gjashtë e rendit të ditës shqyrtimi dhe miratimi propozim vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës nga drejtoria komunale e arsimit i rekomandohet kuvendit në mbledhjen e radhës. Kalojmë në pikën e shtatë, faleminderit drejtoresh. Shqyrtimi dhe miratimi i projektplanit të veprimit për transparencë 2026-2030, sipas kërkesës së MAPL-së e kemi iniciuesin e pikës këtu, zoti Ymer është këtu, mundet me na veç në pikat më shkurt pak, mbasi ka me shkuar dhe në kuvend, mundësisht.

Ymer Berisha: Dy gjëra, domethënë po rritet kërkesa për vendimmarrje transparente dhe normalisht ne komunikojmë si Kosovë, në këtë rast me letra. Nuk ka relevancë te na kush çfarë po thotë, por çfarë po thotë letra dhe jo emri mbiemri. Në këtë rast juristat me komisionin që e kemi shkruar planin e veprimit për transparencë e kanë cituar ligjin për vetë qeverisje lokale dhe jo këtë ligjin e ri që është ndryshuar për udhëzimit administrativ për validimin e afatit të dokumenteve kur

marrin përgjegjësi ligjore, kështu që në faqen 13 të planit të veprimit për transparencë. Ne kemi shkuar me 15 ditë që qeveria e Kosovës dhe ministria e administrimit të pushtetit lokal t'i validojë vendimet e komunës, në këtë rast planin tonë, dhe ata thonë që fuqi më të madhe ekzekutive ka ligji për udhëzimin administrativ i cili parasheh 30 ditë jo 15 po 30. Kështu që në faqen 13 ne tash duhet të bëjmë ndryshimin nga numri 15 në numrin 30, dhe sa i përket ministrisë së administrimit të pushtetit lokal, kjo çështje është ligjore dhe e mbyllur. Por normalisht tani ne e shfrytëzojmë edhe të drejtën pak që t'i avancojmë edhe disa shërbime që komuna e Prizrenit të jetë më konsekuente në transparencën dhe llogaridhënien e vitit 2026 deri në 2030. Meqë na u dha edhe mundësia edhe partiakisht me thënë të drejtën me që Dafina nuk e votoi herën e kaluar dhe pse jo që t'ia japim edhe një rast.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zotri Ymer për sqarime. A kemi diskutime rreth pikës? Atëherë që nuk kemi e hedhim në votim sa jemi për që kjo pikë t'i rekomandohet kuvendit? 7 për. Kundër? 0. Abstenim? 1. Atëherë pika e shtatë pra shqyrtimi dhe miratimi i projektplanit të veprimit për transparencë 2026-2030 vjet sipas kërkesës së MAPL-së i rekomandohet kuvendit në mbledhjen e radhës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës: Raporti financiar për periudhën janar-mars 2026. Vazhdojmë drejtor me prezantimin e pikës, materiale edhe në kuvend shkon qysh të dojnë kuvendarët që do një prezantim të shkurtë?

Dafina Alishani (LVV): A ka çka me na thënë drejtori për KPF-në diçka çka ja vlen me e cek? Sa është vlera totale që është marrë?

Lulzim Sylejmani: Nëse më lejohet raporti domethënë edhe me materialet të cilat i keni marrë e shihni që është domethënë përqindja e shpenzimeve sa është në raport me këtë periudhë zakonisht është më e madhe sesa vitin e kaluar për shkak se i kemi veç 11 milion të ekzekutum të kapitalit e drejtorja e administratës dhe ajo ka e ka rritur përqindjen. Unë ju kam thënë që faktura në pritje të deklaruara në ministrinë e financave kanë qenë 9.5 milion dhe të gjitha obligimet të cilat kanë qenë të faturuara kanë qenë të buxhetuara dhe kanë pasur me u paguar me aprovimin e buxhetit. Telashja është që ne sun po mërrimë me i paguar tash fakturat dhe të njëjtat faktura që kanë qenë në pritje, domethënë tashi ka mundësi me na shku te përmbaruesi dhe me shkaktuar një ...tjetër. Sepse planifikimi ka qenë shumë në rregull i buxhetit për me e la obligimet të cilat janë kriju dhe me filluar me punu me projekt dhe me mundësi. Telashja më e madhe është se ata i kanë marrë te kapitalet, okej te kapitalet i keni marrë janë nalë operatorët s'punojnë i nalë projektet, telashen e kena te mallrat tash 1 milion euro janë marrë te shëndetësia te enjten, 1.9 milion euro ka buxhetin shëndetësia te mallrat krejt 1 milion janë marrë, qysh do të bëjmë furnizim. Se aty prej mallrve s'ka pas as me u lidh po mendoj ndonjë kontratë për me shkruar rrugë as me ndërto, furnizime janë kanë. Furnizime me ato materialet të cilat i bëjnë analizat, furnizime të tjera në mbrohje naft a ku ta di unë. Domethënë telashja është tash që do t'i bëjmë furnizimet me ato ekzekutime që janë bërë. Unë po pres që edhe lëndë të tjera me shku te përmbaruesi, se nëse ne operatorët ekonomik vitin e kaluar për shkak të kontratës kolektive ju kanë marrë 500.000€ po e marr si shembull projektit shadervanit e kemi buxhetuar ne 500.000 ju kanë marrë prapë edhe ti nëse s'ke pare me ai është i detyruar me domethënë ka disa kompani që kanë kapacitet financiar dhe ndoshta na presin, po ka disa të tjera që kanë punëtorë kanë obligime të cilat s'kanë me na prituri dhe kanë me na dërgu atje. Prej kësaj situatë qysh dilet unë për vete aq sa i njoh financat publike nuk e di.

Dafina Alishani (LVV): Dy pyetje i kam lidhur me këto në një për shembull tash nuk e di a është problemi te këta te punëtorët e shëndetësisë që janë me Kosova medin, se s'kanë marrë rrogat që katër muaj nëse s'gaboj ose tre, tre sigurtë e di që jo. A s'po mundemi me i bë presion së paku

këtyre operatorëve me i bë këto pagesa, se tash a e din kjo mallra dhe shërbime që po thoni dhe pagat që komuna i ka obligim po i kuptoj deri diku. Po disa operatorë ekonomik për shembull Kosova medi pse nuk po i paguan rrogat, pyetja ime e parë dhe e dyta zbutjen e kësaj që po merret me përmbarues, a mundet a ka ndonjë formë që mundet për shembull komuna me marrë ndonjë lloj kredie që me e zbut këtë.

Lulzim Sylejmani: Në bazë të ligjit të financave publike domethënë Komuna mundet me marrë kredi kur tre vjet radhazi opinionin e ka pozitiv të opinionin e zyrës së auditimit domethënë opinionin pozitiv duhet me pas tre vjet radhazi. Plus asaj domethënë me ligj është e përcaktuar çka mundesh ti me marrë kredi, nuk mundesh me marrë kredi me i mbulu pagat nuk mundesh me marrë kredi me i mbulu kategori të caktuara, ti mundesh me marrë kredit për investime kapitale në një projekt të caktuar sikur me marrë thashë për shembull kolektorët e ujërave të zeza ose një projekt ma madhor komuna mund me hy në obligime të cilat marrëveshje për kredi i aprovon prapë ministria, qeveria, domethënë nuk mundesh ti kur të duash me hy, janë disa kategori ku mundesh me hy edhe procedurat qysh shkon. Te kjo çfarë suate jeni na këtu, na në takimin që kena pas me drejtorin e buxhetit dhe me drejtorin e thesarit domethënë veç një mundësi është, ministritë projektet që i kan të linjave, ministritë e linjave për projektet nëpër komuna, me i stopuar që ato mjete me i derdh te komunat dhe me i alokuar për projektet ku janë marrë prej përmbaruesit e me vazhduar në bazë planifikimit dhe kërkesën të qytetarëve në përgjime publike. Veç një domethënë, veç një mbështetje financiare me vendimet qeveritare mundet me e ndal këtë trend, përndryshe domethënë është tepër telashe, sepse 1/3 e këtyre parave të cilat i ka marrë përmbaruesi që ka paguar thesare, një e të treta janë shpenzime procedurale, nuk janë borxhe as të kontratës kolektive, nuk janë borxh as te operatorit ekonomik, janë shtesat, domethënë veç po ju jap një shembull, domethënë 120 lëndë me 5€ e 1 cent janë shkuar te përmbaruesi për kamatë në vonesë dhe janë bërë 337€ prej 5€ 1cent. Domethënë prej kësaj suate dilet veç me një vendim të nivelit qëndror me i mbështet obligimet që kanë dalë nga kjo edhe me e ndal këtë trend përndryshe domethënë pritet që ky avaz veç me shku tu keqësu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Lulzim për sqarime.

Ymrane Fusha (PDK): Kryesues sa për përmirsim ka dalë drejtori në një reagim publik 2 milion drejtori i shëndetësisë.

Lulzim Sylejmani: Jo 1 milion prej mallrave, 1 milion prej kapitaleve te shëndetësia.

Dafina Alishani (LVV): Po veç edhe diçka për shembull sot që u bë bartja e mjeteve a nuk mundëm kurrëgjë me ja lënë shëndetësisë, sepse këtu ka paga për shembull neto përmes listës së pagave paga neto përmes listës së pagave 70,000-30,000 mallra dhe shërbime, ato e thatë për pelet, shërbimet komunale, administrimi dhe mbledhja e tatimit në pronë, bile një përqindje me ja pas lënë shëndetësisë, mbasi ashtu është situata.

Lulzim Sylejmani: Domethënë propozimin për bartjen ne e kena bë pak më herët sesa ekzekutimet te mallrat, por te kategoria mallra nuk është telashe nëse kena ne për shembull mallrat te arsimit ose nëse kena te financa për me paguar një faktorë të shëndetësisë për të kategoria e mallrave, domethënë nuk është një telashe me ja marrë një fakturë të me pagu prej drejtorisë tjetër ose naftën për shembull për ngrohje, nëse kemi po e zëm pare te financat, ne mund me marrë një fakturë që ka bërë shpenzim shëndetësia dhe me pagu, nuk është ajo telashe. Telashja është

domethënë që është goxha një vlerë e madhe dhe s'ka as me të hyra të bartura as me asnjë formë që mundesh me me e kompensu.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë faleminderit, e hedhim në votim pikën e rendit të ditës, pikën e tetë të rendit të ditës që t'i rekomandohet kuvendit për mbledhjen e radhës. 8 jemi për unanimisht, pra pika e tetë e rendit të ditës, raporti financiar për periudhën janar mars 2026, i rekomandohet kuvendit për mbledhjen e radhës. Kemi edhe dy pika, pra diskutimi në fillim kur u bë propozimi i këtyre dy pikave, rishqyrtimi i dy vendimeve sipas kërkesës së ministrisë së ekonomisë, pika e nëntë e rendit të ditës dhe pika e dhjetë rendit të ditës. Pika e nëntë: vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionerëve të ndërmarrjes publike, stacioni i autobuseve, shoqëria aksionare Prizren. Këtu debati në fillim ishte e shtjerëm për këtë pikë. E hedhim në votim pra që t'i rekomandohet kuvendit pika e nëntë. 5 për. kundër? 0 kundër. abstenim nuk ka. Pika e nëntë, pra vendimi për formim e komisionit komunal të aksionerëve të ndërmarrjes publike lokale stacioni i autobuzave shoqëria aksionare Prizren i rekomandohet kuvendit për mbledhjen e radhës. Pika e 10: vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionerëve të ndërmarrjes publike lokale ekoregjioni shoqëria aksionare Prizren, edhe këtë pikë që nuk kemi diskutime pra në fillim diskutimet u shtjerren këtu. E hedhim në votim sa jemi për që kjo pikë t'i rekomandohet Kuvendit? 5 jemi për. Kundër? 3 kundër. Edhe kjo abstenim nuk ka. Edhe kjo pikë pra i rekomandohet kuvendit, vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionerëve të ndërmarrjes publike lokale ekoregjioni, shoqëria aksionare Prizren, si pika e 10 e rendit të ditës, që në mbledhjen e radhës pra të jetë në rend dite pra të kuvendit komunal. Ju falenderoj për pjesëmarrjen, shihemi në mbledhjen e radhës në Kuvend, pra ditën e enjte edhe e mbyllim për këtu mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora:
11:50 min



Kryesuesi i KPE-së
Simir Krasniqi